



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 367 Akti

Nr. 530 Vendimi  
Tiranë, më 10.5.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bektashi** Kryesuese  
**Lulzim Hamitaj** Relator  
**Suela Zhegu** Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 4.5.2022, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Guximtar Boçi**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 4.5.2022, kërkoi konfirmimin në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- i. Z. Guximtar Boçi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); si dhe pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit Guximtar Boçi procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Më pas komisionere Firdes Shuli, e shortuar si relator, në datën 18.12.2019 ka paraqitur një kërkesë dorëheqje nga shqyrtimi i kësaj çështje. Në vijim, pasi trupi gjykues i shortuar për shqyrtimin e kërkesës së lartpërmendur e ka pranuar dorëheqjen e komisioneres Firdes Shuli<sup>1</sup>, kjo e fundit është zëvendësuar nga komisioneri Lulzim Hamitaj, i cili kishte qenë i shortuar më herët si anëtar i zëvendësues i kësaj trupe.
- iv. Trupi gjykues i rikompozuar me anëtarin zëvendësues, pasi administroi dhe shqyrtoi të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31- 44 të ligjit nr.84/2016, me vendimin nr. 1, datë 26.12.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të po këtij ligji; dhe (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Guximtar Boçi, me vendimin nr. 2, datë 1.4.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 dhe vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup>Me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.12.2019.

- vi. Komisioni, në datën 1.4.2022, e njoftoi<sup>2</sup> subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë, deri më 20.4.2022.
- vii. Subjekti i rivlerësimit, u paraqit në ambientet e Komisionit në datën 4.4.2022, tërhoqi dosjen përkatëse - dhe pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, paraqiti shpjegimet e tij mbi rezultatet e hetimit kryesisht, në afatin e caktuar nga Komisioni.
- viii. Komisioni, në datën 21.4.2022, pasi administroi prapësimet dhe shpjegimet, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte paraqitur kërkesat për: (i) lejimin dhe marrjen e provave nga Komisioni – duke bashkëngjitur gjashtë deklarata noteriale të shtetasve të ndryshëm, një shkresë të kryetarit të fshatit \*\*\*, datë 19.4.2022, si dhe kishte kërkuar, gjithashtu, thirrjen si dëshmitar të shtetasit A. B.; dhe (ii) pezullimin e përkohshëm të procesit të rivlerësimit.
- ix. Në vijim, në datën 21.4.2022, me vendimin nr. 3, trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesat, dokumentet dhe rrethanat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, vendosi:
- (a) të administrojë të gjitha dokumentet së bashku me prapësimet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti; (b) të mos pranojë kërkesën e subjektit për thirrjen e shtetasit A.B. për të dëshmuar para Komisionit, pasi bazuar në germën “a”, pika 6, të nenit 49, të ligjit nr.84/2016, marrja e provës dukej e panevojshme, për sa kohë ky person ka dhënë deklaratën noteriale nr. \*\*, datë 12.12.2014, mbi faktet dhe rrethanat që u pretenduan të provoheshin nga subjekti nëpërmjet dëshmisë në fjalë; (c) të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e procesit të rivlerësimit ndaj tij – (të kërkuar për shkak të ekzistencës së disa proceseve gjyqësore në shqyrtim e sipër, ku ishte palë dhe që, sipas tij, kishin krijuar një mbingarkesë), për sa kohë nuk u evidentuan shkaqe faktikologjore, në përputhje me nenet 93 dhe 180 të Kodit të Procedurave Administrative, apo rrethana e kushte të cilat do të mundësonin apo përligjinin pezullimin e procesit të rivlerësimit. Lidhur me këtë kërkesë, në aspektin substancial, vërehet fakti që në fazën dhe momentin e paraqitjes së saj, procesi i rivlerësimit ishte në fazën përfundimtare, pasi subjekti kishte paraqitur të gjitha shpjegimet, prapësimet dhe dokumentet përkatëse, në raport me rezultatet e hetimit administrativ që i ishin njoftuar dhe, për rrjedhojë, konkludimi i këtij procesi rivlerësimi nuk kërkonte më ndonjë impenjim të lartë dhe të vazhdueshëm nga subjekti veç paraqitjes në seancë dëgjimore. Gjithashtu, vlen të përmendet se Komisioni – pikërisht, për t'i mundësuar subjektit pjesëmarrjen dhe mbrojtjen e interesave të tij në proceset e tjera gjyqësore – ka shtyrë seancën dëgjimore për në datën 4.5.2022, ndonëse fillimisht ishte programuar për në datën 28.4.2022, siç do të specifikohet në vijim.

<sup>2</sup>Me gjithë përpjekjet e vazhdueshme për dërgimin e e-mail-it të sipër përshkruar, Komisioni ka konstatuar se e-mail-i është kthyer me përmbajtjen “undeliverable”, duke mos mbërritur te subjekti. Komisioni ka tentuar disa herë për dërgimin e tij, por kjo nuk u arrit për shkak të çështjeve teknike – informatike të e-mail-it të subjektit. Në vijim, Komisioni ka kontaktuar subjektin përmes numrit telefonik të kontaktit të vënë në dispozicion prej tij – duke e ftuar atë të paraqitet në ambientet e Komisionit për t'u njohur me dosjen, si dhe për të tërhequr fizikisht rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

- x. Nga ana tjetër, në këndvështrimin formal, trupi gjykues çmoi se ekzistenca e proceseve gjyqësore dhe/ose administrative, lidhur me funksionin dhe statusin e subjektit të rivlerësimit, nuk ndërthureshin dhe as afektonin zhvillimin dhe vijimësinë e procesit të rivlerësimit, i cili kryhet në mënyrë të pavarur nga ecuria e organeve të tjera, që veprojnë secili në sferën e kompetencës dhe të juridiksionit të vet.
- xi. Përpos sa më lart, nëpërmjet pretendimeve të tij, subjekti është shprehur lidhur me një pamundësi financiare të tij, për të kërkuar në institucione të ndryshme dokumente të vlefshme për mbrojtjen e tij në procesin e rivlerësimit. Por, subjekti nuk ka cituar konkretisht se për cilat dokumente bëhej fjalë dhe lidhur me cilin rezultat të hetimeve nuk ishte në gjendje të plotësonte mbrojtjen e tij - veç mosparaqitjes së kërkesës në ASHK, për regjistrimin e një trualli dhe tokës së disponuar/okupuar prej dekadash (pasuria nr. 2), rrethanë kjo pa ndonjë vlerë provuese apo peshë në funksion të mbrojtjes (hipotetike) të subjektit dhe, gjithashtu, pa ndonjë impakt të mundshëm në vendimmarrjen përfundimtare lidhur me këtë proces rivlerësimi. Në këto kushte, trupi gjykues, duke mos konstatuar arsye konkrete pamundësie për t'u mbrojtur apo ndërthurje të këtij procesi me ato të cituara nga subjekti – me objekte krejt të ndryshme – vlerësoi se nuk kishte shkaqe për të vendosur për pezullimin e procesit të rivlerësimit.
- xii. Mospranimi i kërkesave të sipërcituara, për dëgjesën e një dëshmitari dhe pezullimin e procesit të rivlerësimit, i është komunikuar subjektit me anë të postës elektronike në datën 21.4.2022, duke i bërë, gjithashtu, me dije se dokumentacioni i përcjellë prej tij është administruar nga Komisioni së bashku me shpjegimet e prapësimet dhe do të vlerësoj me objektivitet gjatë procesit të vendimmarrjes.
- xiii. Në vijim, në datën 22.4.2022, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të caktuar në datën 28.4.2022, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.
- xiv. Me anë të e-mail-it të datës 26.4.2022 dhe dy e-mail-et e datës 27.4.2022, subjekti ka kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore, duke bërë me dije ekzistencën në të njëjtën ditë të dy seancave gjyqësore në të cilat duhej të ishte i pranishëm<sup>3</sup>.
- xv. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit dhe dokumentet e përcjella në vijim, nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 27.4.2022, ka vendosur të pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit duke ricaktuar seancën dëgjimore në datën 4.5.2022 dhe i ka njoftuar subjektit, përmes postës elektronike, këtë vendimmarrje.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Guximtar Boçi u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z.Tonci Petkovic, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.

<sup>3</sup>Subjekti ka paraqitur nëpërmjet postës së datës 5.4.2022, vendimin nr. \*\*\* regj them., datë 5.4.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrës, për të vërtetuar caktimin e seancës gjyqësore pranë kësaj gjykate në datën 28.4.2022, në orën 10:00. Subjekti ka paraqitur edhe një fletëthirrje nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, datë 8.4.2022, në përmbajtjen e së cilës citohet se seanca është në datën 22.4.2022, në orën 10:00, sipas fletëthirrjes së datës ndërkohë që është bërë një shënim me shkrim dore “seanca në datën 28.4.2022 ora 11:35”.

- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Guximtar Boçi parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe dokumenteve e shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 4.5.2022 u mbyll, për të rifilluar në datën 10.5.2022, për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLGJ-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-ja**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të pasurive;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë në deklaratat e interesave private ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të

lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## A/2. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

### 1. Lidhur me tokën arë, me sipërfaqe 3200 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në fshatin \*\*\*, Gjirokastrë

1. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2008, pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 3200 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin \*\*\*, Gjirokastrë, në pronësi të tij në masën 100%, të përfituar me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”<sup>4</sup>. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë pasuri e zotëron në masën ¼ pjesë të saj<sup>5</sup>. Në mbështetje të deklaratimit të sipërcituar, subjekti ka paraqitur aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. \*\*\*, datë 20.6.2003, nga i cili ka rezultuar se në fshatin \*\*\* familjes së z. Guximtar<sup>6</sup> Ç. Boçi i është dhënë në pronësi tokë arë me sipërfaqe 3200 m<sup>2</sup>.
2. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se kjo pasuri nuk është deklaruar në DIPP-të e viteve 2003 – 2007, sikurse përcaktohet në nenin 6, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”.
3. Nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës<sup>7</sup> (në vijim ASHK) është bërë me dije se pasuria e sipërcituar nuk ka rezultuar e regjistruar në emër të subjektit apo familjarëve të tij. Ndërsa, nga verifikimi i kryer nga Komisioni *online*, në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, është konstatuar se në datën 27.7.2018 është kryer regjistrimi i pasurisë tokë arë me sipërfaqe 3.200 m<sup>2</sup>, në emër të z. Guximtar Boçi.
4. Përgjatë procesit të rivlerësimit, nga Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastrë<sup>8</sup>, është bërë me dije se pas kërkesave të familjeve të fshatit në vitin 2003, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë pajisi Komisionin e Ndarjes së Tokës në fshat me dokumentacion, harta kadastrale, librat e ngastrave të parcelave dhe AMTP. Në zbatim të akteve ligjore, me procesverbalin e datës 5.12.2007, AMTP-të e krijuara të fshatit \*\*\* janë dorëzuar në ZVRPP-në Gjirokastrë.

<sup>4</sup>Sipas nenit 6 të ligjit nr. 7501/1991 dhe VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, familjeve me banim në fshat që në kohën në fjalë nuk ishin anëtarë të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punonin e banonin në ndërmarrjet bujqësore u jepej në përdorim tokë bujqësore sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991 sa ½ e tokës për frymë të anëtarit të kooperativës bujqësore, por jo më shumë se 4 dynym për familje.

<sup>5</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, i pyetur në lidhje me mënyrën dhe kohën e përfitimit të të drejtave reale mbi pasurinë në fjalë subjekti ka paraqitur certifikatën<sup>5</sup> e përbërjes familjare të datës 1.8.1991, ku anëtarë ka qenë subjekti, nëna H. B., bashkëshortja R. B. dhe vajza Ç. B. Referuar ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”, anëtarët e familjes bujqësore kanë qenë bashkëpronarë në këtë pasuri.

<sup>6</sup>Referuar deklaratimit të subjektit, ai ka ndryshuar emrin nga Guxim në Guximtar. Nëpërmjet pyetësorit nr. 5, subjekti i është kërkuar të bëjë me dije mbi arsyet e këtij ndryshimi, si dhe të paraqesë dokumentacionin ligjor provues për të. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se Guxim ishte emri me të cilin thirrej në jetën e përditshme. Pavarësisht kërkesës së bërë prej tij për të bërë ndryshimin e emrit, në Zyrën e Gjendjes Civile Gjirokastrë rezultoi se përsëri figuronte i regjistruar me emrin Guximtar. Subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues mbi sa më sipërdeklaruar në pyetësor.

<sup>7</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.11.2017, së bashku me dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI.

<sup>8</sup>Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2021.

5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi është pyetur nga Komisioni, në lidhje me shkakun e mosdeklarimit të pasurisë në analizë në DIPP-të e viteve 2003-2007, subjekti ka sqaruar se deklarimi nuk është bërë për shkak të interpretimit të gabuar të ligjit prej tij. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në pasurinë në fjalë nuk është kryer asnjë investim duke paraqitur foto aktuale të parcelës.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

6. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ të kristalizuara dhe të njoftuara nga Komisioni, ka paraqitur shpjegimet e tij, nëpërmjet të cilave, veç sa më sipër, ka pretenduar se mosdeklarimi i kësaj pasurie në deklaratat e interesave private, përgjatë viteve 2003 – 2007, ka ndodhur për shkak të marrjes me vonesë të AMTP-ve nga Komuna \*\*\*. Subjekti ka pretenduar se pasuria është fituar në mënyrë të ligjshme dhe, për pasojë, nuk mund të konkludohet se pasaktësia në deklarim është bërë me qëllim për ta fshehur atë.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

Trupi gjykues – ndonëse nuk i kishte kaluar barrë prove subjektit për pasurinë e llojit tokë arë me sipërfaqe 3.200 m<sup>2</sup> – në vijim të analizës së materialit të administruar – vëren se objekt vlerësimi në procesin e rivlerësimit, ndër të tjera, janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura, ndër vite, pranë ILDKPKI-së. Megjithatë, lidhur me faktin e provuar dhe të pranuar të mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratat e interesave private, përgjatë viteve 2003 – 2007, ndonëse përbën një mospërmbushje të detyrimeve ligjore asokohe në fuqi, mbetet në nivelin e një deklarimi të pasaktë në vitet përkatëse dhe i shëruar nëpërmjet deklarimeve të mëpasshme përpara deklaratës *Vetting* dhe në këtë të fundit.

7. Në këto kushte: (i) nisur nga fakti se nga Komisioni nuk janë konstatuar problematika në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie; (ii) fakti që kjo pasuri është deklaruar saktësisht në vitin 2008, si dhe, më pas, në deklaratën *Vetting*; (iii) në referencë edhe të qëndrimit tashmë të konsoliduar të Kolegjit, lidhur me vlerën dhe peshën e pasaktësive në deklaratimet ndër vite dhe mënyrën se si ato interpretohen në analizën e përgjithshme të kriterit të vlerësimit të pasurisë<sup>9</sup>, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratat e interesave private, përgjatë viteve 2003 – 2007, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme, nuk mund të shërbejnë si një shkak për të konkluduar se ky mosdeklarim mund të kualifikohet si një shkelje e dispozitave ligjore të parashikuara në gerमत “b” dhe “c”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

#### **2. Shtëpi banimi (e rrënuar), me truall funksional prej 850 m<sup>2</sup> dhe tokë (livadh) rreth 1000 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin \*\*\*, Gjirokastër**

8. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë pasurinë *shtëpi banimi të pabanuar, truall funksional me sipërfaqe 850 m<sup>2</sup> dhe tokë livadh me sipërfaqe rreth 1000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në fshatin \*\*\*, Gjirokastër - të trashëguar nga brezat paraardhës*. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se këto pasuri nuk janë regjistruar<sup>10</sup>, pasi

<sup>9</sup>Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, prg. 26.2., (JR).

<sup>10</sup>ASHK-ja Gjirokastër ka bërë me dije për ILDKPKI-në, nëpërmjet postës elektronike të datës 27.6.2019 se në fshatin \*\*\*, Njësia Administrative \*\*\*, Bashkia Gjirokastër, përveç AMTP-ve nuk disponon asnjë dokumentacion tjetër, për arsye se,

nuk kanë kaluar në sistem regjistrimi në ZVRPP-në Gjirokastrë<sup>11</sup>.

9. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, të lëshuar nga Njësia Administrative \*\*\*, në të cilin është cituar se: “ *Shtetasi Guximtar Boçi ka në pronësi në \*\*\*, Gjirokastrë, një shtëpi banimi të amortizuar dhe truall funksional rreth 850 m<sup>2</sup>, e trashëguar nga brezat paraardhës dhe tokë livadh rreth 1.000 m<sup>2</sup>”.*
10. Përgjatë hetimit administrativ, nga Njësia Administrative \*\*\*<sup>12</sup>, është bërë me dije<sup>13</sup> se nuk disponohen dokumente veç vërtetimit të datës 12.7.2021, të lëshuar nga kryetari i fshatit<sup>14</sup>. Pjesa tjetër e dokumentacionit, në lidhje me pasurinë në analizë, i është dërguar ASHK-së.
11. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur dy foto të parcelës së tokës në analizë dhe të ndërtesës së rrënuar, si dhe një vërtetim të datës 12.7.2021, të lëshuar nga Njësia Administrative \*\*\*<sup>15</sup>. Subjekti ka sqaruar se nuk disponon dokumentacion për përfitimin e pasurisë, pasi këto prona nuk kanë qenë të regjistruara. Pas saktësimit të sipërfaqeve dhe hedhjes së tyre në sistemin e ASHK-së, pasuria<sup>16</sup> ka rezultuar e përbërë nga trualli me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> dhe livadh me sipërfaqe 740 m<sup>2</sup>.
12. Komisioni ka konstatuar se, si në hartën treguese të pasurisë të nxjerrë nga sistemi multifunksional i ASHK-së, po ashtu edhe nga fotot e paraqitura nga subjekti, sikurse nga kërkimi në faqen *google earth*, është evidentuar prezenca e dy ndërtesave me mur të përbashkët, që dukej se ishin mbi truallin e sipërcituar, ku njëra prej tyre dukej në gjendje të banueshme dhe e përfunduar/ndërtuar me çati, ndërsa tjetra e rrënuar.
13. Në lidhje me konstatimin e mësipërm, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 dhe 4, subjekti ka sqaruar se vetëm trualli është i tij, kurse ndërtesa e plotë që dukej në foto ishte e djalit të xhaxhait të tij<sup>17</sup>. Ndërsa në lidhje me ndërtesën e amortizuar/rrënuar, subjekti ka deklaruar se përgjatë viteve 1990 – 1996, ka qenë banesë e familjes së tij.
14. Në lidhje me pasurinë e llojit livadh, subjekti ka deklaruar se atë e ka përfituar me anë të parashkrimit, si rezultat i përdorimit të pandërprerë prej tij, për 30 vitet e fundit.
15. Në mbështetje të deklaramëve të tij, subjekti ka paraqitur kartelat e dy pasurive të paluajtshme, përkatësisht: (i) *pasuria nr. \*\*\**, e llojit arë, me sipërfaqe 720 m<sup>2</sup>, në pronësi “shtet” dhe me shënimin “kjo pasuri okupohet nga Guximtar Boçi”; (ii) *pasuria nr. \*\*\**,

---

z.k. \*\*\*, \*\*\*, është në proces regjistrimi fillestar dhe nuk janë marrë ende në dorëzim (regjistrat kadastrale, hartat kadastrale, listë printimet).

<sup>11</sup>Gjithashtu, edhe nga verifikimi i kryer *online*, nga Komisioni, në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, nuk ka rezultuar e regjistruar kjo pasuri, as në emër të subjektit dhe as në emër të personave të lidhur.

<sup>12</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021.

<sup>13</sup>Përcjellë në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021

<sup>14</sup>Dokument në formën e një shkrese të thjeshtë, me shkrim dore dhe e pavulosur nga kryetari i fshatit

<sup>15</sup>Sipas vërtetimit subjekti është pronar i një trualli me sipërfaqe 300m<sup>2</sup>, një shtëpi e rrënuar dhe livadh me sipërfaqe 700m<sup>2</sup>.

<sup>16</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka sqaruar se nuk disponon dokumentacion, pasi këto prona nuk kanë qenë të regjistruara dhe vetëm kohët e fundit janë kryer matje digjitale të sipërfaqeve dhe përfundimet e tyre janë depozituar pranë ASHK-së Gjirokastrë dhe është bërë hedhja në hartë e pronës dhe saktësimi i sipërfaqeve, nga ku ka rezultuar se përbëhet nga trualli me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> dhe livadh me sipërfaqe 740 m<sup>2</sup>. Subjekti ka vënë në dispozicion të njëjtat foto të parcelës dhe shtëpisë së rrënuar dhe ka sqaruar se shtëpia është tërësisht e rrënuar dhe sot ekziston vetëm trualli.

<sup>17</sup>Megjithëse i është kërkuar të paraqesë foto të qarta të të dy ndërtesave që ndodhen në pasurinë e tij, subjekti ka paraqitur sërish të njëjtat foto, si ato dërguara në përgjigjet e pyetësorit nr. 2.



*e llojit truall, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, në pronësi “shtet”, me shënimin “kjo pasuri është në përdorim nga Guximtar Boçi”.*

16. Nga shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti, Komisioni ka konstatuar se në kartelën e pasurisë nr. \*\*\*, të llojit truall, me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, në pronësi “shtet”, në rubrikën “ përkshkrim i veçantë”, është pasqyruar shënimi: *“Mbi këtë truall ndodhet një ndërtesë, pjesërisht rrënojë”.*
17. Lidhur me sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigjet e pyetësorëve përgjatë procesit të rivlerësimit kanë rezultuar kontradiktore dhe të pambështetura tërësisht në prova, krahasuar me çka ka rezultuar nga hetimi administrativ. Kjo pasi, sikurse u citua më sipër, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar fillimisht se e drejta e pronësisë është përfituar prej tij nga trashëgimia nga brezat paraardhës. Më pas, subjekti ka deklaruar se pasuria në fjalë është përfituar me okupim, ndërsa për truallin ka deklaruar se është përfituar me parashkrim. Megjithëse kontradiktor në deklaratimet e tij, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor që të vërtetonte mënyrën dhe kohën e përfitimit të të drejtave reale mbi këto pasuri.
18. Në përfundim, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit duhej t’i kishte deklaruar këto pasuri, për sa kohë i ka okupuar/zotëruar dhe përdorur – sikurse edhe ka pohuar<sup>18</sup>.
19. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, sa i takon këtyre pasurive, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me rezultatet e mëposhtme:
  - *Duket se për periudhën 2003 – 2016, ka mungesë deklarimi nga subjekti, të zotërimit të pasurisë godinë/shtëpi, truall dhe tokë livadh, si dhe të shpenzimeve përkatëse, të ndodhur në fshatin \*\*\*, Gjirokastër.*
  - *Duket se subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor lidhur me origjinën/mënyrën e përfitimit/zotërimit të pasurive godinë/shtëpi, truall dhe tokë livadh.*
  - *Duket se në pasurinë e subjektit, të deklaruar vetëm si truall dhe shtëpi e amortizuar, ekziston edhe një godinë (përbri ndërtesës së rrënuar) e padeklaruar prej tij as ndër vite dhe as në deklaratën *Vetting*, e cila duket si pasuri e fshehur.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

20. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka shpjeguar se ka pasur në zotërim një shtëpi të ndodhur në fshatin \*\*\*, të trashëguar nga gjyshi i tij prej vitit 1970. Këtë pasuri e ka deklaruar në deklaratën e vitit 2003, si një shtëpi të rrënuar për shkak të mosmirëmbajtjes dhe mungesës së investimeve, e cila sot nuk ekziston më. Pasuria në fjalë përdorej prej tij dhe të atit.
21. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës shkresën e datës 18.4.2022, nga kryesia e fshatit \*\*\*, në të cilën është cituar se: *“Shtetasi Guximtar Boçi ka qenë banor i këtij fshati dhe se dispononte një shtëpi banimi të trashëguar nga babai i tij”.*

---

<sup>18</sup>Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

22. Ndërsa në lidhje me ndërtesën tjetër, subjektit ka deklaruar se ajo ka qenë e ndërtuar me mur të përbashkët me shtëpinë e shtetasit H. B. (djali i xhaxhait të subjektit). Ky i fundit, banesën e tij e ka restauruar dhe është në gjendje banimi.
23. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar dhe shpjeguar lidhur me këto pasuri edhe përgjatë seancës dëgjimore, duke specifikuar se kufiri i pronës së tij tokë/truall, përfundon/kufizohet, pikërisht, aty ku gjendet muri ndarës i përbashkët midis këtyre dy ndërtesave, duke përsëritur se ajo i përket djalit të xhaxhait të tij.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

24. Në vijim të analizimit të sqarimeve dhe provave të paraqitura, ndonëse subjekti është shprehur se pasurinë në analizë e ka deklaruar në DIPP-në vitit 2003, Komisioni ka konstatuar se ky deklarim nuk rezulton se është kryer në vitin 2003. Kësisoj pretendimi i subjektit nuk qëndron, për sa kohë nuk gjen mbështetje dhe konfirmim nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni.
25. Gjithashtu, pas disa kërkesave të Komisionit të nisura gjatë hetimit administrativ, nga FSHU-ja<sup>19</sup>, nëpërmjet postës elektronike të datës 29.4.2022, është përcjellë një kontratë e lidhur për furnizimin me energji elektrike për pasurinë truall me nr. \*\*\*, të ndodhur në z.k. \*\*\*, lidhur me godinën/banesën e plotë (ngjitur me atë të rrënuarën). Kjo kontratë ka rezultuar e lidhur në vitin 2009 në emër të shtetasit H. B. Ky institucion ka përcjellë edhe procesverbalin e datës 4.5.2022, të mbajtur nga OSHEE-ja për verifikimin e kontratës sipas adresës së pasurisë në fjalë, si dhe foto të saj.
26. Nga shqyrtimi i materialit të përcjellë, lidhur me inspektimin në terren, ka rezultuar se në ndërtesën e sipërcituar, aktualisht, nuk ka matës të instaluar dhe as linjë për furnizimin me energji elektrike. Kontrata me nr. \*\*\*, për furnizimin me energji elektrike të kësaj ndërtese, e lidhur në emër të shtetasit H. B., ka rezultuar e pezulluar në vitin 2015.
27. Nga UKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2022, është bërë me dije se nuk ka rezultuar kontratë e lidhur për furnizimin me ujë të pijshëm për ndërtesën e sipërpërmendur.
28. Nisur nga sa më lart, në raport me dyshimet mbi zotërimin e mundshëm nga subjekti edhe të godinës tjetër të parrënuar, vlerësohet se lidhja e kontratës me FSHU-në prej vitit 2009 nga shtetasi H. B. – pikërisht, nga personi që subjekti e ka përshtuar si pronarin/zotëruesin e kësaj pasurie, si dhe djalin e xhaxhait të tij – përbën një fakt provues që shkon në mbështetje të pretendimit të subjektit – ndonëse mbeten të paqarta pasaktësitë apo mospërkimi i kufijve që duken nga dokumentacioni i paraqitur nga ASHK-ja.
29. Në këto kushte, për sa kohë nuk kanë rezultuar prova që subjekti është zotërues *de facto* i banesës së parrënuar – përkundrazi në këtë cilësim është evidentuar shtetasi H. B., – trupi gjykues vlerëson se nuk mund t'u qëndrohet rezultateve të njoftuara lidhur me këtë pikë, përpos faktit që ndërtesa në fjalë sipas hartës së ASHK-së duket se ndodhet në

<sup>19</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2022, Komisioni i është drejtuar FSHU-së, duke i kërkuar të paraqesë kontratën për furnizimin me energji elektrike për banesën në fjalë, si dhe pagesat e kryera për këtë shërbim. Ndërsa me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2022, i është drejtuar UKT-së.

truallin që është në proces regjistrimi në emër të subjektit. Kësisoj, pavarësisht dyshimit të ngritur më herët, në rezultatet e hetimit, në rrethanat e reja, nuk mund të konsiderohet i provuar fakti që subjekti të ketë zotëruar dhe të zotërojë edhe këtë ndërtesë.

30. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht dyshimeve të ngritura në rezultatet e hetimeve paraprake dhe të dyshimeve të pjesshme që mund të mbeten lidhur me përmbajtjen e dokumenteve të paraqitur nga ASHK-ja, duke mbajtur në vëmendje edhe përmbajtjen e vërtetimeve të Njësisë Administrative dhe të kryetarit të fshatit - si më lart - nuk u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se ndërtesa në gjendje të banueshme ishte në zotërim/përdorim nga ana e subjektit, apo i përkiste atij. Për rrjedhojë, nuk konstatohen elemente penalizues për subjektin, për sa i takon kësaj pasurie. Gjithashtu, lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie, ndër vite, por që është deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, për sa kohë nuk kanë rezultuar investime fillestare apo në vijim, trupi gjykues vlerëson se edhe në këtë rast vlen arsyetimi i bërë lidhur me mosdeklarimin, ndër vite, të pasurisë nr. 1 dhe, për rrjedhojë, nën këtë aspekt, nuk konstatohen shkaqe penalizuese për subjektin.
31. Gjithashtu, edhe për sa i përket mënyrës së përfitimit me *okupim* (sipas deklarimeve të subjektit), të pasurisë truall dhe livadh në analizë, trupi gjykues vlerëson se ky fakt në vetvete nuk mund të përbëjë një problematikë në raport me aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Por, nga ana tjetër, kjo mënyrë përfitimi/përvetësimi, jo në përputhje me dispozitat ligjore dhe, kësisoj, si një veprim jo etik dhe korrekt për figurën e një gjyqtari, do të mbahet në konsideratë së bashku me deklaratimet kontradiktore dhe të ndryshuara në vijimësi prej tij, lidhur me këto pasuri, për një vlerësim të përgjithshëm të këtij aspekti në kuadër të procesit të rivlerësimit gjithëpërfshirës të subjektit.

### **3. Shtëpi banimi, me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 1340 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në \*\*\*, Gjirokastrë**

32. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, një shtëpi banimi me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, si dhe truall me sipërfaqe 1350 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten, në masën ½ pjesë të saj secili. Si burim për krijimin e kësaj banese, subjekti ka deklaruar kontributin familjar, me vlerë fillestare të ndërtimit në shumën 1.500.000 lekë (pa përfshirë truallin). Ndërsa, për pasurinë e llojit truall, subjekti ka deklaruar se e ka përfituar nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 8.9.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të KKKP-së.
33. Në mbështetje të deklaratimit të mësipërm, subjekti ka paraqitur vërtetimin hipotekor me nr.\*\*\*, datë 18.10.2004, nga ZVRPP-ja Gjirokastrë. Në këtë dokument është pasqyruar se në pasurinë e llojit truall, me sipërfaqe 1340 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, është ndërtuar objekti banesë me dy kate me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, rivlerësuar në vlerën 18.099.035 lekë<sup>20</sup>.

---

<sup>20</sup>Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të shpjegojë nëse janë kryer investime/shpenzime restaurimi, duke e ftuar të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon vlerën e shpenzuar (preventiv/situacion punimesh etj.), për rikonstruksionin e mundshëm të shtëpisë, që do të justifikonte rritjen e vlerës në shumën e rivlerësuar prej 18.099.035 lekësh, duke specifikuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se në rivlerësim janë llogaritur vlera e ndërtimit, që është tetëfishuar në krahasim me vlerën e investimit fillestar

34. Përgjatë hetimit administrativ ka rezultuar se me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.7.2004, KKKP-ja<sup>21</sup> ka njohur si ish-pronar të ndjerin Ç. B.<sup>22</sup>, për sipërfaqen totale prej 12.218 m<sup>2</sup>. Më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.9.2004, KKKP-ja ka vendosur të kompensojë me 2000 m<sup>2</sup> truall ekuivalent trashëgimtarin Guximtar Boçi<sup>23</sup>, në vendin e quajtur \*\*\*, në Gjirokastrë.
35. Nga ZVRRP-ja<sup>24</sup> është bërë me dije se me anë të vendimit të sipërcituar të KKKP-së, dy pasuritë e llojit truall janë përkatësisht: (i) me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe prej 1340 m<sup>2</sup>; dhe (ii) me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe prej 660 m<sup>2</sup>, janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.
36. Gjithashtu, ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 29.9.2004, subjekti e ka shitur truallin me sipërfaqe prej 660 m<sup>2</sup>, në favor të shtetasit L. P., në vlerën 100.000 lekë.
37. Komisioni ka konstatuar se shitja e truallit me sip. prej 660 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së sipërpërmendur, nuk është deklaruar në DIPP-në e vitit 2004. I pyetur nga Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin dhe tjetërsimin e kësaj pasurie në DIPP-në e vitit 2004, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar si shkak për këtë mosdeklarim interpretimin e gabuar të ligjit prej tij. Ndërsa, në lidhje me marrëdhënien me blerësin e truallit, subjekti ka deklaruar se me z. L. P. nuk ka pasur asnjë marrëdhënie<sup>25</sup>, përveç faktit që është kufitar me banesën e tij.
38. Nga ZQRPP-ja Gjirokastrë<sup>26</sup> është bërë me dije se shtetasi Guximtar Boçi ka të regjistruar pasurinë me nr. \*\*\*<sup>27</sup>, nr. hipotekor \*\*\*, datë 18.10.2004, e cila përbëhet nga trualli me

---

në vitet 1993 – 1998, si dhe vlera e truallit llogaritur sipas standardeve dhe vlerave të përcaktuara me VKM dhe, për këto arsye, ka arritur atë vlerë. Gjithashtu, ka bërë me dije se nuk janë kryer punime restauruese, por vetëm riparime të vogla mirëmbajtëse.

<sup>21</sup>Në këtë vendim është cituar se këto prona janë marrë dhe përdorur nga shteti dhe bazuar në ligjin nr. 7916, datë 12.4.1995, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993”, për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, e gjithë sipërfaqja është konsideruar e zënë (më pas është ndarë për banorët, sipas ligjit “Për tokën”) dhe ka vendosur të kompensohen trashëgimtarët në një nga format që parashikon neni 16 i ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e Pronave ish-Pronarëve”, i ndryshuar.

<sup>22</sup>Në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI kanë rezultuar formularët e aplikimit dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 19.7.2004 nga KKKP-ja Gjirokastrë, për kthimin dhe kompensimin e pronave të të ndjerit Ç. B. sipas të cilit kanë qenë në fshatin \*\*\* të Gjirokastrës si vijon: (i) parcela nr. \*\*\* me sip. 3182 m<sup>2</sup>, tokë arë; (ii) parcela nr. \*\*\* me sip. 2160 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e lirë; (iii) parcela nr. \*\*\* me sip. 1380 m<sup>2</sup>, terren i lirë; (iv) parcela nr. \*\*\* me sip. 1496 m<sup>2</sup>, tokë arë; (v) parcela nr. \*\*\* me sip. 4000 m<sup>2</sup>, terren i lirë. Lidhur me këto ish-prona të babait të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Arkivit Qendror dhe Drejtorisë së Arkivit të Qarkut Gjirokastrë për të vënë në dispozicion dosjet e tyre. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Drejtorja e Arkivit Qendror ka bërë me dije se në bazë të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, neni 77 citon se kërkesat e institucioneve shtetërore dhe joshtetërore për të dhëna arkivore, kopje dhe ekstrakte dokumentesh që ruhen në arkivat shtetërore plotësohen kundrejt pagesës sipas tarifave të miratuara nga Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave. Nga dëshmia e trashëgimisë, trashëgimtarët ligjorë janë S. B., F. Sh. (B.), F. P. (B.) dhe Guximtar Boçi që trashëgojnë me 1/4 pjesë/secili.

<sup>23</sup>Me kërkesën e tij.

<sup>24</sup>ZQRPP-ja Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.8.2017, datë 1.12.2017, ka bashkëlidhur përgjigjen e ZVRRP-së Gjirokastrë, e cila konfirmon se shtetasi Guximtar Boçi ka të regjistruar në regjistrin me nr. \*\*\* hipotekor, datë 29.7.2014, pasurinë me nr.\*\*\*, e llojit “truall” me sip. 2000 m<sup>2</sup>, ndodhur në G\*\*, me kontratë shitje kalon duke u regjistruar me nr. \*\*\* hipotekor, datë 18.12.2014, me pronar Z. N. ZVRRP-ja ka sqaruar, më pas, se në këtë shkresë është bërë një lapsus dhe, në vijim, nëpërmjet postës elektronike të datës 27.6.2019 ka rikonfirmuar se në emër të subjektit figuron e regjistruar pasuria nr.\*\*\* regjistruar në nr. \*\*\* hipotekor, datë 18.10.2004, regjistruar me leje ndërtimi për objektin.

<sup>25</sup>Në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, të dërguar nga Komisioni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë shtetasin L. P.

<sup>26</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 21.8.2017, ZVRRP-ja Gjirokastrë, me shkresën e datës 1.12.2017 dhe posta elektronike datë 27.6.2019.

sipërfaqe 1340 m<sup>2</sup>, mbi të cilin ngrihet objekti banesë me sipërfaqe 121 m<sup>2</sup>, regjistruar me leje ndërtimi, ndodhur në \*\*\*, Gjirokastër<sup>28</sup>.

39. Në vijim, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacion ligjor, që vërteton momentin/vitin e ndërtimit dhe koston e investimit përkatës të deklaruar prej tij. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka shpjeguar se shtëpia e banimit në fjalë është ndërtuar përgjatë viteve 1994 – 1998, nga persona të ndryshëm dhe jo nga një firmë ndërtimi. Subjekti ka deklaruar se ka filluar të banojë në këtë apartament në datën 17.12.1998<sup>29</sup> dhe se nuk disponon dokumente, pasi regjistrimi i pronës është bërë disa vite më vonë.
40. Përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka administruar<sup>30</sup> nga ASHK-ja dosjen e pasurisë në analizë. Nga shqyrtimi i dosjes në fjalë është konstatuar se subjekti ka marrë në dorëzim pasurinë me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, me aktдорëzimin e datës 12.9.2004<sup>31</sup>. Në këtë dosje gjendej edhe aktkolaudimi i objektit nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2004, ku vlera e përcaktuar për përfundimin e punimeve ka qenë 1.036.000 lekë, ndërsa koha e fillimit dhe përfundimit nuk ka qenë e përcaktuar në këtë akt.
41. Nga Komuna \*\*\*, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2004, i është përcjellë ZVRPP-së dokumentacioni për konfirmimin zyrtar të përfundimit të ndërtimit të objektit<sup>32</sup>. Pjesë e dokumentacionit ka qenë edhe leja e ndërtimit me nr. \*\*\*, e cila mban datën 26.9.2003, ndërkohë që titulli i pronësisë së truallit është fituar me VKKP-në nr. \*\*\*, datë 8.9.2004.
42. I pyetur në lidhje me mospërputhjen në kohë të akteve, siç është evidentuar më sipër, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 5, se shkak ka qenë fakti se veprimet për fitimin e pronësisë mbi tokën janë bërë pasi është marrë sheshi i ndërtimit dhe pasi është ndërtuar shtëpia e banimit.
43. Ndërsa, i pyetur në lidhje me mospërputhjen midis sipërfaqes së ndërtimit të miratuar me vendim të KKRRT-së prej 121 m<sup>2</sup> dhe asaj të rezultuar në kartelën e pasurisë prej 141 m<sup>2</sup>, subjekti ka sqaruar se ka qenë një gabim teknik i zyrës së regjistrimit, pasi *de facto* disponon sipërfaqen e ndërtimi prej 121 m<sup>2</sup>.

---

<sup>27</sup>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në lidhje me këtë pasuri ka rezultuar se me anë të bashkimit të pasurisë truall me nr. \*\*\* dhe pasurisë së llojit godinë me nr. \*\*\* është krijuar pasuria me nr. \*\*\*, e përbërë nga trualli me sip. 1340 m<sup>2</sup> dhe ndërtesa me sip. 141 m<sup>2</sup>.

<sup>28</sup>Nga FSHU-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020, është bërë me dije se në emër të subjektit nuk kanë rezultuar kontrata me këtë institucion. Ndërsa për personat e lidhur ka bërë me dije se në emër të shtetases R. B. rezulton një kontratë në instancën Tiranë dhe në emër të T. A. (babai i bashkëshortes së subjektit) identifikohet një kontratë në instancën Gjirokastër. Nga UKT-ja, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2020, është bërë me dije për Komisionin se nuk kanë rezultuar kontrata të lidhura për shërbime me Ujësjellës Kanalizime, të regjistruara në sistem në emër të subjektit apo personave të lidhur. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka bërë me dije se zona në \*\*\* nuk furnizohet me ujë nga UKGj-ja, pasi nevojat për ujë i kanë plotësuar nëpërmjet një pusi, si dhe ka paraqitur vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2022, nga FSHU-ja që abonenti Guximtar Boçi figuron me kontratë furnizimi prej muajit prill të vitit 2009.

<sup>29</sup>Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale, nr. \*\*\* , datë 25.2.2020, të shtetasit L. M., e paraqitur së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, për të provuar momentin e largimit nga shtëpia e deklaruesit, të cilën subjekti e kishte në përdorim kundrejt qirasë. Përgjatë hetimit administrativ, në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, dërguar nga Komisioni, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë shtetasin L. M., por ka rezultuar se ka gjykuar çështjen civile ku palë ka rezultuar vëllai i tij, shtetasi N. M., për të cilën ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 9.07.2003, me objekt “vërtetimi i faktit të lindjes së fëmijës”.

<sup>30</sup>Nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021.

<sup>31</sup>Përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2021

<sup>32</sup>Këtij dokumenti i bashkëngjiten kopjet e akteve vijuese: leja për sheshin e ndërtimit; leja e ndërtimit; procesverbali i kolaudimit të objektit; leja e shfrytëzimit ose e banimit të objektit; si dhe plani i vendosjes së objektit.

### 3.1. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie

44. Në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për ndërtimin e shtëpisë së banimit të ardhurat e familjes. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar përgjatë procesit të rivlerësimit, dokumentet e vetme të rezultuara lidhur me kohën dhe mënyrën e përfitimit të pasurisë kanë qenë vendimi nr.\*\*\*, datë 19.7.2004, i cili dëshmon momentin e kalimit të të drejtave reale mbi pasurinë e llojit truall, si dhe leja e ndërtimit e datës 26.9.2003, për ndërtimin e banesës. Në këto kushte, deklarimi i subjektit se ndërtimi i banesës ka përfunduar në vitin 1998 ka rezultuar i pa mbështetur në prova.
45. Gjithashtu, të pa provuara me dokumentacion kanë rezultuar edhe kostot përkatëse për investimin e kryer. Në këto kushte, Komisioni ka kryer përlllogaritjet sipas të dhënave të EKB-së për vlerat mesatare të kostove të ndërtimit të banesave në vitet 1995 – 1998<sup>33</sup>. Në pamundësi objektive të përcaktimit të periudhës ekzakte të kryerjes së punimeve, ndër vite, Komisioni ka konsideruar në analizë mesataren e kostos së ndërtimit të viteve 1995 – 1998, e cila ka rezultuar në vlerën 20.869 lekë/m<sup>2</sup>. Bazuar në këtë përlllogaritje, për ndërtimin prej 121 m<sup>2</sup>, kostoja ka rezultuar në vlerën totale prej 2.525.149 lekësh.
46. Komisioni ka konsideruar këtë vlerë në analizën financiare, si nivel bazik për përcaktimin e kostos së ndërtimit, nën të cilën nuk mund të jetë. Nga Njësia Ligjore e Komisionit janë kryer përlllogaritjet e të ardhurave të familjes së subjektit, përgjatë periudhës 1995 – 1998, si vijon:
- a. të ardhura të subjektit, nga punësimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në shumën 939.515 lekë;
  - b. të ardhura nga shitja e truallit të ndodhur në \*\*\*, Gjirokastrë, në shumën 700.000 lekë;
  - c. letra me vlerë të përfituara nga statusi si ish i dënuar politik i babait të subjektit, z. Ç. B., në vlerë nominale 1.336.719 lekë.

#### 3.1.1 Të ardhura nga shitja e truallit në \*\*\*, Gjirokastrë

47. Nga dokumentacioni i administruar përgjatë procesit të rivlerësimit ka rezultuar se nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 6.8.1998, subjekti i rivlerësimit ka shitur një pasuri të llojit truall me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>, të ndodhur në \*\*\*, Gjirokastrë, në vlerën 700.000 lekë<sup>34</sup>.
48. Subjekti ka deklaruar<sup>35</sup> se këtë pasuri e ka blerë me kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 5.8.1998. Kontrata është nënshkruar mes tij dhe seksionit të financës, pranë Bashkisë Gjirokastrë dhe çmimi ka qenë i përcaktuar në vlerën 144.000 lekë.

<sup>33</sup>Referuar vendimeve përkatëse të viteve 1995, 1996, 1997 dhe 1998, kosto mesatare për ndërtim në qytetin e Gjirokastrës, për sipërfaqe ndërtimi kanë qenë përkatësisht 14.861 lekë/m<sup>2</sup>; 23.086 lekë/m<sup>2</sup>; 23.086 lekë/m<sup>2</sup> dhe 22.442 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>34</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., të datës 21.8.2017.

<sup>35</sup>Në pyetësorin nr. 3, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime mbi shitjen në kësaj pasurie kundrejt një vlerë rreth 5-fish më të lartë se çmimi i blerjes, vetëm pas një dite. Në përgjigjet e tij, subjekti ka parashtruar se çmimi i blerjes së truallit në vlerën 144.000 lekë, ka qenë çmimi me të cilin operonte Bashkia Gjirokastrë për shitjen e trojeve për ndërtim në këtë periudhë dhe është shitur me vlerën e tregut në periudhën përkatëse sipas vullnetit të palëve. I pyetur nga Komisioni në lidhje me marrëdhënien me shtetasit e sipërcituar, subjekti ka deklaruar se me shtetasit U. Sh. dhe E. Gj. ka lidhje

49. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka përcjellë përgjigjen e datës 1.12.2017, të ZVRPP-së Gjirokastër, në të cilën është cituar se shtetasi Guximtar Boçi ka pasur të regjistruar në regjistrin me nr. hipotekor \*\*\*, datë 5.8.1998, pasurinë në analizë.
50. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ka paraqitur një kërkesë për shesh ndërtimi pranë Bashkisë Gjirokastër. Në vijim, Zyra e Urbanistikës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.7.1996, të Këshillit të Bashkisë, i ka parashtruar KRRT-së dhënien e sheshit të ndërtimit. Kjo e fundit, pasi ka analizuar procedurat ligjore, ka nxjerrë vendimin për dhënien e sheshit të ndërtimit nr. \*\*\*, datë 1.3.1996.
51. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, të dërguar nga Komisioni, i pyetur në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie, subjekti ka sqaruar se këtë pasuri e ka përfituar në cilësinë e personit të pastrehë, pasi trualli që dispononte në \*\*\*, ishte larg qytetit. Subjekti ka deklaruar se, më pas, vendosi ta shiste truallin prej 600 m<sup>2</sup>, duke qenë se kishte filluar ndërtimin në truallin e ndodhur në \*\*\*.
52. Përgjatë hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës<sup>36</sup> së Komisionit, Bashkia Gjirokastër ka bërë me dije se nuk disponon asnjë informacion/dokumentacion, në lidhje me 600 m<sup>2</sup> të përfituar nga subjekti i rivlerësimit, pasi dosja me dokumentacionin përkatës ndodhej pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastër. Në vijim, pas kërkesës së Komisionit<sup>37</sup>, nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër është bërë me dije se pranë arkivit të këtij institucioni nuk disponohej materiali i kërkuar.
53. Komisioni, bazuar në situatën faktike të përshkruar më sipër, për të përcaktuar ligjshmërinë e përfitimit pasurisë në fjalë, çmon të marrë në analizë ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha” dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, që kanë qenë në fuqi në kohën kur pasuria është përfituar. Referuar nenit 2 ligjit të sipërcituar, përcaktohen se çdo familje e pastrehë përfitonte falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash, në varësi të pjesëtarëve të familjes dhe moshës së tyre. Përkufizimi i “të pastrehëve” është bërë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993, sipas pikës 1 të të cilit quhen *“të pastrehë” qytetarët të cilët nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave; janë me banim të përkohshëm në ndërtesa që nuk hyjnë në fondin e banesave, si konvikte, shkolla etj.; banojnë në ndërtesa që nuk përmbushin kushtet higjieno-shëndetësore; banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, si dhe ata që janë qiramarrës në banesa private, si dhe ata që si pasojë e vendimeve gjyqësore rezultojnë me strehim të përkohshëm.*
54. Në rastin konkret, siç ka rezultuar nga aktet e administruara përgjatë hetimit, si dhe ato të vëna në dispozicion nga subjekti, në kohën e përfitimit të truallit ai nuk ka qenë i pastrehë. Pas largimit nga shtëpia e banimit të ndodhur në fshatin \*\*\* (të trajtuar në pasurinë nr. 2, në këtë vendim), në pritje të përfundimit të ndërtimit të banesës së tij të ndodhur në \*\*\* të Gjirokastërës, për të cilën kishte filluar punimet në vitin 1994, subjekti kishte paraqitur kërkesën për sheshndërtimi në Bashkinë Gjirokastër. Me vendimin

---

farefisnore, pasi nënën e tyre e ka vazhën e tezes. Në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, dërguar nga Komisioni, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ku palë të kenë qenë shtetasit e sipërpërmendur.

<sup>36</sup>Nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021.

<sup>37</sup>Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2022.

nr.\*\*\*, datë 1.3.1996, “Për dhënien e sheshit të ndërtimit”, nga KRT-ja Gjirokastrë ishte miratuar sheshndërtimi për truallin me sip. 400 m<sup>2</sup>. Mbetet e paqartë dinamika dhe ligjshmëria e dhënies së këtij sheshndërtimi, për shkaqet e mëposhtme, si dhe nisur nga fakti se ky truall është blerë nga subjekti – me palë shitëse Seksioni i Financës së Rrethit Gjirokastrë – me aktin noterial të datës 5.8.1998, duke mos qenë ai, kësisoj, pronari i truallit në momentin që i është dhënë sheshi dhe leja e ndërtimit.

55. Duke mbajtur në vëmendje sa më lart dhe në këndvështrim të kuadrit ligjor të sipërcituar, vlerësohet se subjekti nuk përfshihej në kategoritë e përfituesve, sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, për sa kohë dispononte tjetër banesë dhe truall. Kjo rrethanë konfirmohet edhe nga fakti që subjekti nuk e ka përdorur ndonjëherë këtë truall për destinacionin e përfituar – për strehim – por, përkundrazi, e ka shitur atë vetëm një ditë pasi kishte fituar të drejtat reale të pronësisë së tij<sup>38</sup>.
56. Për rrjedhojë, nisur nga sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, trupi gjykues çmon se: (i) subjekti i rivlerësimit ka përfituar një shesh ndërtimi në zonën e \*\*\*, Gjirokastrë, si familje e pastrehë, ndërkohë që me sa ka rezultuar përgjatë hetimit administrativ, ai dhe familja e tij nuk i plotësonin kushtet për të pasur statusin e familjes së pastrehë. Ndonëse, ky konstatim i është kaluar si barrë prove subjektit, ai nuk ka shpjeguar apo provuar të kundërtën; (ii) trualli në fjalë, prej 400 m<sup>2</sup>, është shitur nga subjekti vetëm një ditë pasi e kishte blerë atë, madje për një vlerë rreth pesë herë më shumë se çmimi i blerjes. Ky fakt tregon se përfitimi i këtij trualli nga subjekti kishte ndodhur për përfitim financiar dhe jo për shkak të nevojës konkrete për strehimin e tij familjar – sikurse ishte qëllimi formal i dhënies së truallit nga organet kompetente; (iii) nuk u provua me dokumentacion ligjor përmbushja e kritereve ligjore për përfitimin e këtij trualli dhe nëse subjektit të rivlerësimit i takonte të përfitonte strehim apo truall për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës.
57. Në këto kushte, duke rezultuar se veprimet e ndërmarra nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer me qëllim realizimin e përfitimeve monetare dhe jo për të plotësuar nevojat për strehimin e familjes së tij dhe në mungesë të provës se përfitimi i këtij trualli kishte ndodhur komfor kritereve ligjore, Komisioni çmon se kjo rrethanë mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe, për rrjedhojë, do të mbahet në vëmendje në përfundim, për kryerjen e një vlerësimi tërësor, të ndërthurur edhe me fakte të tjera të kësaj natyre.

### **3.1.2 Të ardhura nga letrat me vlerë të babait të subjektit**

58. Përgjatë procesit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor përfitimin e letrave me vlerë nga babai i tij, si dhe qëllimin e përdorimit të tyre.
59. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka deklaruar se me transaksionet e letrave me vlerë është marrë nëna e tij, e cila ka bërë marrëveshje verbale me trashëgimtarët e tjerë, në

---

<sup>38</sup>Sipas kontratës së shitjes, nr.\*\*\*, datën 6.8.1998, me çmim 700.000 lekë, nënshkruar përpara noteres E. S., ndërkohë kjo pasuri ishte blerë një ditë më parë me çmimin prej 144.000 lekësh.



mënyrë që këto letra me vlerë t'i përdorte për të kontribuar në nevojat e familjes ku bashkëjetonte. Shumat monetare të përfituara nga këto letra me vlerë janë përdorur për ndërtimin e shtëpisë së banimit, si dhe në ndërtimin e shtëpisë së banimit të ndodhur në \*\*\*, në Gjirokastrë.

60. Subjekti ka paraqitur librezën e kursimeve për një llogari të çelur në datën 2.12.1994, në Bankën e Kursimeve në letra me vlerë privatizimi, në shumën totale prej 1.336.719 lekësh. Nga shqyrtimi i saj ka rezultuar se: në datën 2.12.1994 janë tërhequr letra me vlerë nominale 350.700 lekë; në datën 6.2.1995 janë tërhequr letra me vlerë nominale 300.600 lekë; në datë 9.2.1996 letra me vlerë nominale 501.000 lekë; si dhe kanë mbetur letra me vlerë nominale që përkonin me vlerën 184.419 Lekë.
61. Ndonëse nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor, subjekti ka shpjeguar se vlera prej 350.700 lekësh i është dhënë shtetasit A. B. për privatizimin e objektit të ish-NPV-së Gjirokastrë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ky shtetas i ka kthyer shumën 50.000 lekë, menjëherë, ndërsa shumën 300.000 lekë ia ka kthyer në vitin 2010. Vlera prej 501.000 lekësh i është shitur shtetasit N. B. për të privatizuar një magazinë dhe, më pas, i ka kthyer vlerën 500.000 lekë. Ndërsa vlera prej 300.600 lekësh është shitur në tregun e lirë me 80% të vlerës së letrave me vlerë.
62. Komisioni ka konstatuar se nga vlerat e tërhequra nga trashëgimtarët e z. Ç. B., shuma e përfitur në vlerë monetare dhe e mundshme për përdorim deri në vitin 1998 ka qenë në total 790.480 lekë<sup>39</sup>.
63. Në lidhje me ligjshmërinë e përdorimit të këtyre shumave vetëm nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se me vendimin, nr. \*\*\*, datë 1.7.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është çelur trashëgimia ligjore e prindërve të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, subjekti, motrat dhe vëllezërit e tij, kanë trashëguar ¼ e pasurisë së tyre, secili.
64. Pavarësisht se të drejtat që kanë buruar nga trashëgimia, përfshirë edhe të ardhurat nga letrat me vlerë, *de jure*, kanë lindur me vendimin e sipërcituar, subjekti *de facto* ka përfitur të ardhura nga letrat me vlerë, përpara se sa të çelej trashëgimia ligjore dhe të drejtat mbi letrat me vlerë u takonin të gjithë trashëgimtarëve të të ndjerit, në masën 1/5 pjesë takuese secili, përfshirë edhe nënën e tij. Për rrjedhojë, Komisioni duke marrë në konsideratë edhe deklarinimin e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, se nëna e tij ka kontribuar në ndërtimin e shtëpisë, ka njohur në analizën financiare vetëm 2/5 (pjesa takuese e vetë subjektit dhe nënës së tij) e shumës prej 790.480 lekësh dhe, konkretisht, shumën 316.192 lekë.
65. Nga Njësia Ligjore, gjithashtu, janë kryer përlllogaritjet e shpenzimeve të familjes së subjektit, përgjatë së njëjtës periudhë, përkatësisht:
  - shpenzime jetese të familjes në masën 620.080 lekë (përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave nga pagat);
  - shpenzim për blerjen e truallit të ndodhur në \*\*\*, Gjirokastrë, në masën 144.000 lekë.

---

<sup>39</sup>Përkatësisht 500.000 lekë, 80% e shumës 300.600 lekë dhe 50.000 lekë, dhënë nga z. A. B.

66. Në përfundim të analizës së mësipërme, duket se për kryerjen e investimit të kryer në ndërtimin e banesës në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 1.333.522 lekë<sup>40</sup>, siç është detajuar në tabelën vijuese.

|  |                    |
|--|--------------------|
| Të ardhura nga paga 95 - 95            | 939 515            |
| Të ardhura nga shitja e truallit 98    | 700 000            |
| Të ardhura nga letrat me vlerë 94-98   | 316 192            |
| Shpenzim për blerjen e truallit 98     | - 144 000          |
| Shpenzime jetese 95-98                 | - 620 080          |
| Shpenzim për ndërtimin e banesës 95-98 | - 2 525 149        |
| <b>Rezultati</b>                       | <b>- 1 333 522</b> |

67. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka bërë me dije se përgjatë periudhës 1990 – 1992 ka punuar në Këshillin e Bashkuar \*\*\*. Më pas në vitin 1993-1994 ka punuar si mësues në shkollën 8-vjeçare “\*\*\*\*”, në fshatin \*\*\*, Gjirokastrë.

68. Komisioni ka vlerësuar se përpos faktit që këto periudha punësimi nuk janë të provuara me dokumentacion ligjor – nisur nga periudha e kohore në fjalë dhe niveli i inflacionit në vitet e tranzicionit të sistemit social-politik në Shqipëri asokohe dhe nga marzhi minimal i mundësive për të kursyer në ato vite – këto të ardhura, edhe nëse do të konsideroheshin, ndonëse do të përmirësonin disi situatën, nuk do të përmbysnin rezultatin sa i përket pamundësisë financiare me burime të ligjshme për ndërtimin e kësaj pasurie.

69. Për sa më sipër, në lidhje me këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, si dhe i ka kaluar barrën e provës, si vijon:

- *Ndonëse subjekti ka deklaruar përfundimin e ndërtimit të shtëpisë në vitin 1998, nga dokumentacioni i ASHK-së, duket se dhënia e sheshit dhe lejes së ndërtimit është përfituar jo në përputhje me kriteret ligjore, pasi i përket vitit 2003, ndërsa përfitimi i të drejtave të pronësisë mbi truallin i përket vitit 2004.*
- *Duket se për pasurinë e llojit shesh ndërtimi me sipërfaqe 400 m<sup>2</sup>, në qytetin e Gjirokastrës, mbetet e paqartë nëse është përfituar apo jo në përputhje me kriteret ligjore përcaktuese, për sa kohë subjekti i rivlerësimit kishte përfituar edhe më herët një tjetër shesh ndërtimi, ndonëse nuk gëzonte statusin e familjes të pastrehë.*
- *Duket se për ndërtimin e banesës në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.333.522 lekë.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

70. Subjekti ka paraqitur një analizë financiare, duke pretenduar të konsiderohen në analizën financiare të ardhura nga:

- a) *shitja e letrave me vlerë, tek z. N. B. 500.000 letra me vlerë në shumën 500.000 lekë; letrat me vlerë të shitura në tregun e lirë 300.000 letra me vlerë me 80% , në shumën prej 240.000 lekësh;*
- b) *shitja e bagëtive në vitin 1995, në vlerën totale prej 513.000 lekësh;*

<sup>40</sup>Edhe nëse do të konsideroheshin si të disponueshme të gjitha letrat me vlerë, në masën 790.480 lekë, sërish do të kishim në këtë pikë një pamundësi financiare prej rreth 1.300.000 lekë.

c) shitja e truallit vlerën 700.000 lekë;

d) të ardhura nga kompensimi i pensionit të nënës nga statusi i të përndjekurit politik në vlerën 200.000 lekë.

71. Nga sa më sipër, subjekti ka pretenduar se ka pasur ë ardhura në vlerën totale 3.092.515 lekë. Gjithashtu, subjekti ka bërë me dije se ka pasur të ardhura të tjera nga shitja e produkteve blegtorale dhe bujqësore, si dhe të ardhura përgjatë kësaj periudhe, nga shitja e pjesës tjetër të letrave me vlerë në treg të lirë në shumën 92.209 lekë. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:

a) *deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 8.4.2022, e lëshuar nga z. N. B., i cili është shprehur se i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 500.000 lekësh në këmbim të letrave me vlerë;*

b) *deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 17.4.2022, e lëshuar nga z. Z. Sh., i cili ka deklaruar se subjekti i rivlerësimit është vëllai i gruas së tij dhe se në vitin 1995 subjekti i ka shitur bagëtinë me vlerën totale 513.000 lekë.*

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

72. Në vijim të analizimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar, lidhur me pretendimin për të përfshirë në analizë të ardhurat në vlerën 513.000 lekë nga shitja e bagëtive, trupi gjykues vlerëson se: (i) kjo e ardhur është pretenduar për herë të parë pas marrjes së rezultateve të hetimit; (ii) nuk është paraqitur ndonjë provë apo dokumentacion i kohës, për përfitimin apo ekzistencën e këtyre bagëtive, përveç një deklaratë noteriale aktuale të paraqitur me prapësimet; si dhe (iii) nuk është deklaruar ndonjëherë si burim për pasurinë në analizë, ndër vite, apo në deklaratën *Vetting* dhe, për pasojë, këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

73. Për sa i përket pretendimit të subjektit mbi përvetësimin e letrave me vlerë të përfituara më herët dhe të përdorura për periudhën e pretenduar 1994 – 1996, trupi gjykues vlerëson se, megjithëse pretendohet se përfitimi i këtyre të ardhurave ka qenë i legjitimuar nëpërmjet prokurës me nr. \*\*\*, datë 17.5.2011, nga shqyrtimi i përmbajtjes së këtij dokumenti ka rezultuar se përmes saj subjekti është mandatar për tërheqjen dhe përdorimin e të ardhurave nga dëmshpërblimi në “Raiffeisen Bank” dhe jo për ato të përfituara më herët nga letrat me vlerë (të cilat gjithsesi ishin tërhequr deri në vitin 1996). Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ i pambështetur në prova dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

74. Lidhur me të ardhurat nga pensioni i nënës, si pasojë e përfitimit të statusit të të përndjekurit politik, nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion nga subjekti, që do të vërtetonte përfitimin e statusit të të përndjekurit politik të nënës së tij, për t’u klasifikuar më pas për përfitimin e ndonjë pensioni të mundshëm. Subjekti ka pretenduar të ardhurat në vlerën prej 200.000 lekë, vetëm pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk u vërtetua me dokumentacion ligjor, pretendimi i subjektit mbetet deklarativ dhe të ardhurat e pretenduara nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

75. Për rrjedhojë, bazuar në dokumentacionin e administruar përgjatë procesit të rivlerësimit, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.333.522 lekë, e konstatuar në rezultatet e njoftuara, mbetet e pandryshuar.
76. Lidhur me sa u analizua më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se: (i) subjekti ka përfituar 400 m<sup>2</sup> truall, në \*\*\*, në Gjirokastër, si i pastrehë, ndërkohë që nuk përfshihej në kategoritë e përfituesve sipas ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”; (ii) ky truall është shitur vetëm një ditë pas blerjes së tij për një vlerë rreth 5-fish më të madhe se çmimi i blerjes; (iii) nuk u provua me dokumentacion ligjor ligjshmëria e përfitimit të pasurisë; (iv) mospërdorimi i truallit, sipas qëllimit e destinacionit të dhënë, për strehim; (v) subjekti ka bërë deklaram të pasaktë të pasurive ndër vite; (vi) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 1.333.522 lekë.
77. Në këto kushte – ndonëse konstatimet e sipërpërshkruara nuk kanë efekt lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave përkatëse nga shitja – ato do të mbahen në konsideratë në një vlerësim tërësor, në referim të standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, sipas ligjit nr. 96/2016 dhe Parimeve të Bangalores, në raport me cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, sipas pika 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

#### **4. Apartament banimi, në vlerën 2.700.000 lekë, në emër të znj. Ç. B., me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*”, Gjirokastër**

78. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në deklaratën *Vetting*, apartamentin e banimit të ndodhur në vendin e quajtur \*\*\*, në Gjirokastër, në pronësi të vajzës së tij Ç. B., në masën 100%, në vlerën 2.000.000 lekë. Si burim për krijimin e saj, subjekti ka deklaruar të ardhurat e vajzës nga paga dhe shpërblimet.
79. Në mbështetje të deklaramit të mësipërm, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, të datës 14.10.2016, në të cilën shtetasja Ç. B. ka deklaruar se në vitin 2011 ka porositur ndërtimin dhe, më pas, blerjen e një apartamenti banimi<sup>41</sup> te shitësi I. D.<sup>42</sup> person fizik, kundrejt pagesës totale prej 2.000.000 lekësh. Subjekti ka sqaruar se vlera totale e apartamentit ishte përcaktuar në shumën 3.200.000 lekë. Nga viti 2011 – 2016, subjekti ka deklaruar se janë paguar *cash*, me këste të vazhdueshme çdo vit nga 400.000 lekë, në total 2.000.000 lekë dhe ka mbetur detyrimi në vlerën 1.200.000 lekë. Në vijim, me likuidimin total të detyrimit do të nënshkruhej dhe kontrata e shitjes së objektit dhe kalimi i pronësisë së apartamentit te shtetasja Ç. B.<sup>43</sup>.

<sup>41</sup>Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit nr. 3, pagat e vajzës dhe bashkëjetuesit të saj dhe kreditë e marra në vazhdimësi.

<sup>42</sup>Shtetasi I. D. ka rikonfirmuar me anë të përgjigjes së tij të datës 25.7.2017, ndaj shkresës nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2017 të dërguar nga ILDKPKI-ja, se znj. Ç. B. ka porositur një apartament dhe ka rikonfirmuar pagesat e kryera. Komisioni i ka kërkuar subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të sqarojë mbi marrëdhënie të mundshme shoqërore/familjare apo çështje të gjykuara prej tij ku palë të ketë qenë I. D., apo shoqëria. Subjekti ka deklaruar se shtetasin I. D. ka pasur marrëdhënie juridike kontraktuale A. H. dhe Ç. B. dhe përveç kësaj me këtë shtetas nuk ka asnjë marrëdhënie tjetër të çfarëdo lloji. Në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, të dërguar nga Komisioni, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ku palë të ketë qenë shtetasi I. D. apo shoqëria e tij.

<sup>43</sup>Subjekti ka sqaruar se shoqëria nuk disponon fatura për pagesa të kryera, pasi ato janë regjistruar me mandatpagesa të thjeshta, pasi fatura do të pritët me bërjen e kontratës së shitjes dhe fakti i kalimit të pronësisë do të bëhet pasi të dalë certifikata e pronësisë.

80. Komisioni ka konstatuar se, megjithëse apartamenti në fjalë është porositur në vitin 2011, ai nuk ka rezultuar i deklaruar nga subjekti/apo personi i lidhur në deklaratën periodike të këtij viti dhe as në ato në vijim.
81. I pyetur nga disa herë nga Komisioni nëpërmjet pyetësorëve nr. 2, 3 dhe 4, në lidhje me dokumentacionin që provon pagesat, kohën e kryerjes së tyre dhe dokumentacionin që provon burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se pagesat janë kryer nga bashkëpronari A. H.<sup>44</sup>, bashkëjetuesi i vajzës, i cili ka paraqitur dokumentacionin vetëm për tri pagesa, konkretisht: në vlerën 250.000 lekë, në datën 8.12.2017; në vlerën 250.000 lekë, në datën 8.12.2019; si dhe në vlerën 200.000 lekë, në datën 23.10.2020. Në vijim, sipas marrëveshjes me shitësin është përpiluar kontrata e shitjes<sup>45</sup>. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumente lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për likuidimin e çmimit të apartamentit në fjalë.
82. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve të sipërcituar, ka deklaruar se shtetasi A. H. në mesin e vitit 2013 ka bërë marrëveshje me shtetasin I. D. lidhur me blerjen e apartamentit, për të paguar me këstet: në vitin 2013, vlerën 800.000 lekë; si dhe në vitet 2014, 2015 dhe 2016 nga 400.000 lekë. Gjithashtu, ka sqaruar se në këtë apartament kanë filluar të banojnë në mesin e vitit 2017, pasi kanë bërë punimet dhe arredimin e nevojshëm. Në momentin e shkëputjes së vajzës Ç. B. nga trangu familjar, ajo ka jetuar me qira në banesën e shtetasit K. B. për gjashtë muaj dhe më pas në banesën e nënës së bashkëjetuesit<sup>46</sup> A. H.
83. Në përfundim të analizës dhe shqyrtimit të deklarimeve të subjektit, lidhur me pasurinë në analizë, Komisioni ka konstatuar se deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionit të dorëzuar fillimisht prej tij së bashku me këtë deklaratë, krahasuar me ato të pretenduara më pas përgjatë procesit të rivlerësimit, janë kontradiktore dhe jo bindëse.
84. Për sa më sipër, Komisioni konstatuar sa vijon:
- *Duket se ka mospërputhje midis burimit të deklaruar në deklaratën *Vetting*, nga të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e vajzës së subjektit me pjesë takuese 100%, ndërsa në përgjigje të pyetësorëve janë shtuar të ardhurat e bashkëjetuesit dhe kredia.*
  - *Duket se ka mospërputhje midis deklarimit të vajzës së subjektit në deklaratën noteriale të vitit 2016 për porositjen nga ana e saj në vitin 2011 të apartamentit në fjalë, krahasuar me deklarimin e subjektit në përgjigje të pyetësorëve se apartamenti është porositur nga bashkëjetuesi në mesin e vitit 2013.*
  - *Duket se ka mospërputhje midis deklarimit të vajzës së subjektit në deklaratën noteriale të vitit 2016 se pagesat janë kryer prej saj dhe kanë filluar që nga momenti i porositjes në vitin 2011 dhe është paguar shuma prej 400.000 lekësh çdo vit,*

<sup>44</sup>Subjekti ka deklaruar se në emër të shtetaseve Ç. B. dhe A. H. figuron e regjistruar edhe pasuria apartament 1+1, e ndodhur në Sarandë, me certifikatë pronësie lëshuar në datën 16.26.2021, vlera e përcaktuar në masën 3.500.000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kredinë e marrë në vlerën 2.950.000 lekë dhe 550.000 lekë nga kursimet familjare. Kredia është marrë në bazë të garancisë së pagave të tyre dhe të ardhurave të aktivitetit privat të A. H., “\*\*\*\*”.

<sup>45</sup>Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës dokumentin e pronësisë dhe mandatpagesat e kryera bashkëlidhur e-mail-it.

<sup>46</sup>Subjekti ka paraqitur dokumentin hipotekor të shtëpisë së shtetases I. H., nëna e bashkëjetuesit A. H.

*krahasuar me deklarin e subjektit në përgjigje të pyetësorëve se pagesat janë kryer prej bashkëjetuesit të vajzës duke u paguar 800.000 lekë në vitin 2013 dhe nga 400.000 lekë në vitet pasardhëse.*

#### **4.1. Për këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:**

85. Kontratën e shitjes me nr. \*\*\*, datë 23.10.2020, me të cilën është përfituar pronësia mbi këtë pasuri. Në këtë kontratë është cituar se çmimi i shitjes së këtij apartamenti ka qenë në vlerën 2.700.000 lekë dhe se është bërë rivlerësimi i çmimit të shitjes në vlerën 2.701.800 lekë. Subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se kontrata është lidhur me disa vjet vonesë për shkak të problemeve që ka pasur ndërtuesi me regjistrimin e pronës në ASHK-në Gjirokastër, si dhe ka paraqitur së bashku me përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe 3, kontratën e shitblerjes së sipërcituar, e cila ka rezultuar e panënshkruar nga palët.
86. Shkresat nr. \*\*\*, datë 21.8.2017 dhe 1.12.2017, nga ZVRPP-ja Gjirokastër, nëpërmjet së cilave është konfirmuar se nuk kanë rezultuar pasuri të regjistruara, në emër të shtetasës Ç. B.
87. Në përgjigje të shkresës<sup>47</sup> së dërguar nga Komisioni, ASHK-ja<sup>48</sup> ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar pasuri të regjistruara në emër të shtetasit A. H. Ndërkohë që nga verifikimi i kryer *online*, nga Komisioni në sistemin multifunksional të ASHK-së për institucionet, është konstatuar kartela e pasurisë së llojit apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, me adresë, lagjja “\*\*\*\*”, Gjirokastër, e regjistruar në datën 13.1.2021. Në këtë pasuri, referuar kartelës, shtetasja Ç. B. ka rezultuar bashkëpronare në masën ½ me shtetasin A. H.

#### **4.2. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

88. Përpos mospërputhjeve, për sa i përket deklarin të burimeve për krijimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve, Komisioni, nisur dhe nga fakti që pasuria në fjalë është regjistruar në emër të të dy bashkëpronarëve, vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit në masën 50% secili, ka konsideruar në analizë të ardhurat e të dyve.
89. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se vajza e subjektit gjatë vitit 2014 ka investuar në depozitë me afat shumë prej 600.000 lekë dhe gjatë vitit 2015 edhe 200.000 lekë të tjera. I pyetur nga Komisioni, lidhur me burimin e krijimit për këto shuma të investuara, subjekti i rivlerësimit është shprehur se vajza e tij ka filluar punë në dhjetor të vitit 2010 dhe nga momenti i fillimit e deri në momentin e shkëputjes nga trangu familjar, ka kursyer pjesën më të madhe të pagës. Kur është shkëputur nga trangu familjar ka pasur të kursyer shumë prej 1.000.000 lekësh, të cilat i ka përdorur, më pas, për investimet në depozita me afat, për pagimin e kësteve të apartamentit dhe arredimin e tij.
90. Nga shqyrtimi i deklarinëve periodike të subjektit të rivlerësimit, në të cilat ka pasur detyrim të deklarojë edhe vajza madhore e subjektit deklarues, nuk ka rezultuar deklarimi i ndonjë kursimi të disponuar prej saj në formën *cash*. Pranimi i pretendimit deklarativ të subjektit për ekzistencë fondesh në vitin 2013, të cilat për herë të parë deklarohen pas

<sup>47</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2021.

<sup>48</sup>Informacion i përcjellë nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2021.

rezultateve me bilanc negativ të hetimit administrativ, bie ndesh me konceptin e deklarimit të pasurive dhe me praktikën e mirëkonsoliduar nga Kolegji për t'u bazuar në akte dhe prova – siç janë deklaratat periodike vjetore<sup>49</sup>, lidhur me këtë çështje – deklarimi, ndër vite, është e vetmja mënyrë për të identifikuar kursime të mundshme në formën *cash*, ndër vite, për sa kohë nuk mund të provohen në asnjë mënyrë tjetër – Komisioni nuk e ka pranuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

91. Në vijim, Komisioni ka kryer analizën financiare për secilin prej kësteve të paguara, duke i qëndruar variantit të deklaruar nga vajza e subjektit në deklaratën *Vetting*, për fillimin e pagimit të kësteve nga viti 2011. Në këtë analizë janë përfshirë edhe të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së subjektit deri në vitin 2013, kur është bërë shkëputja nga trangu familjar, si fizikisht edhe ligjërisht.
92. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni është konstatuar se shtetasi A. H.<sup>50</sup> ka filluar marrëdhëniet e punësimit në gusht të vitit 2013 dhe, për pasojë, nuk janë përfshirë kursime të mundshme të tij përpara fillimit të bashkëjetesës.
93. Drejtoria e Hetimit Tatimor, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2021<sup>51</sup>, ka bërë me dije Komisionin se shtetasi A. H. ka regjistruar aktivitetin e tij person fizik në datën 17.2.2020, përtej periudhës së analizuar.
94. Nga analiza financiare, e detajuar në tabelën vijuese, duket se vajza e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëjetuesi kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 3.249.025 lekë, për të paguar këstet e apartamentit, përballuar shpenzimet e familjes dhe krijuar kursimet e tyre në llogaritë bankare përkatëse, përgjatë viteve 2013, 2014 dhe 2015.

| Viti                                      | 2011           | 2012           | 2013               | 2014               | 2015            |
|---|----------------|----------------|--------------------|--------------------|-----------------|
| Të ardhura nga paga Ç. B.                 | 432 149        | 449 814        | 663 518            | 699 840            | 702 804         |
| Të ardhura nga paga A. H.                 | -              | -              | 151 708            | 349 787            | 515 682         |
| Të ardhura nga prindërit                  | 1 860 848      | 1 103 898      | -                  | -                  | -               |
| Shpenzime të vitit                        | - 627 042      | - 628 696      | - 261 351          | - 522 414          | - 508 552       |
| Shtesë në kursime në llogari bankare/cash | - 876 347      | - 271 694      | - 1 273 761        | - 2 038 320        | - 362 087       |
| Shpenzim për blerjen e apartamentit       | - 400 000      | - 400 000      | - 400 000          | - 400 000          | - 400 000       |
| <b>Rezultati</b>                          | <b>389 608</b> | <b>253 322</b> | <b>- 1 119 886</b> | <b>- 1 911 107</b> | <b>- 52 153</b> |

95. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime, si dhe i ka kaluar barrën e provës, në lidhje me sa vijon:
  - *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar pasurinë e përshkruar më sipër në emër të personit të lidhur/Ç. B. në deklaratat e interesave private nga viti 2011 dhe në vijim, përveçse në deklaratën *Vetting*.*
  - *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të vajzës së subjektit në deklaratën *Vetting* dhe atyre të deklaruara prej subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit.*
  - *Duket se personi i lidhur dhe bashkëjetuesi, përgjatë periudhës 2013, 2014 dhe 2015,*

<sup>49</sup>Vendimi JR nr.14, datë 15.6.2021, par. 35; paragrafët 19.4., 20.3., 20.4. dhe 21.1 të vendimit JR 23/2019; si dhe paragrafët 84 e 85 të vendimit JR 19/2018.

<sup>50</sup>Nga DPSHTRr-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2021, është bërë me dije se z. A. H. ka të regjistruar në pronësi të tij dy automjetet me targa \*\*\* dhe \*\*\*, të cilat nuk janë blerë përgjatë periudhës së analizuar.

<sup>51</sup>Në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2021, të Komisionit.

*kanë pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën prej 3.249.025 lekësh për të kryer pagesat e kësteve të apartamentit në analizë, përballuar shpenzimet e familjes dhe për të krijuar kursimet e rezultuara.*

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

96. Subjekti ka pretenduar se apartamenti në analizë është porositur në vitin 2013, vit në të cilin vajza Ç. B. është larguar nga familja, ku fillimisht ka qëndruar për 6 muaj me qira në banesën e shtetasit K. B. dhe, më pas, në banesën e nënës së bashkëjetuesit, deri sa përfunduan punimet në apartamentin e porositur. Shkëputja e saj nga trangu familjar ka qenë edhe arsyeja e mosdeklarimit të kontratës së porosisë në deklaratën periodike të këtij viti, megjithatë ajo është deklaruar në deklaratën *Vetting*.
97. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare të pagesave të apartamentit, konkretisht shumën 800.000 lekë, në vitin 2013 dhe shumën 400.000 lekë në vitin 2016, si dhe të përlllogaritet shpenzimi për qiranë vetëm për një periudhë 6-mujore, sipas deklarimit të bërë nga qiradhënësi. Subjekti ka pretenduar që të konsiderohen kursimet e vajzës së tij nga të ardhurat e saj nga pagat përgjatë periudhës përpara shkëputjes nga trangu në masën 1.000.000 lekë, të cilat i ka përdorur, më pas, për blerjen dhe mobilimin e apartamentit. Subjekti ka kërkuar të kryhet korrigjimi i një gabimi të kryer nga Komisioni në formulën e ndryshimit të likuiditeteve në vitin 2014, çka do të pakësonte balancën negative. Po ashtu, ka kërkuar që për depozitën me afat të bashkëjetuesit të vajzës së tij në masën 1.253.000 lekë, të mos përfshihet në analizë, duke pretenduar se kjo ishte krijuar me të ardhura të tij nga emigracioni, për të cilat nuk disponon dokumentacion. Në përfundim të sa më sipër, subjekti ka paraqitur analizën financiare me një balancë negative në shumën 517.875 lekë. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës:
- a. *deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 18.4.2022, të lëshuar nga z. K. B., i cili është shprehur se vajza e subjektit dhe bashkëjetuesi i saj kanë jetuar me qira në shtëpinë e tij vetëm për 6 muaj dhe kontrata e qirasë është zgjidhur me marrëveshje mes palëve;*
  - b. *deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 19.4.2022, të lëshuar nga z. I. D., i cili është shprehur se në vitin 2013 ka bërë një marrëveshje me shtetasin A. H. për porositjen e apartamentit dhe pagesat janë kryer përkatësisht në shumën 800.000 lekë në vitin 2013 dhe nga 400.000 lekë në vitet 2014, 2015 dhe 2016. Në vitin 2016, ai ka nënshkruar deklaratën noteriale me vajzën e subjektit, meqenëse bashkëjetuesi i saj nuk ndodhej në Gjirokastër.*

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

98. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në lidhje me pasaktësinë e përcaktimit të vitit kur është porositur apartamenti, vlerëson se pretendimi i tij se vajza nuk ka pasur dijeni për momentin e porositjes apo për kohën e kryerjes së pagesave të kësteve, nuk qëndron. Ky pretendim i subjektit bie ndesh me përmbajtjen e deklaratës noteriale me nr. \*\*\*, datë 14.10.2016, të nënshkruar nga vajza dhe shitësi I. D. –të cilën e ka paraqitur pranë Komisionit, në cilësinë e provës. Për rrjedhojë, deklarata me nr. \*\*\*, datë 19.4.2022, e paraqitur nga



subjekti, pasi është njohur me rezultatet e hetimit, përbën një deklaram kontradiktor me deklaratën e vitin 2016. Kësisoj, në sajë të një çmimi të vlerës provuese së tyre, trupi gjykues vlerëson se deklarata e vitit 2016 prevalon, për sa kohë është më e hershme, përpara fillimit të procesit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, mund të konsiderohet më e zhveshur nga qëllimet e tentativat rregulluese dhe përshtatëse të fakteve, në favor të mbrojtjes dhe interesit të subjektit, në raport me rezultatet e njoftuara.

99. Lidhur me shpenzimet e qirasë, Komisioni ka vlerësuar të pranojë pretendimet e subjektit, duke i përfshirë në analizën financiare shpenzimet në fjalë vetëm për periudhën 6-mujore të pretenduar prej tij, çka ka sjellë një përmirësim të balancës negative me vlerën 122.153 lekë, të shpërndarë përgjatë viteve 2013 – 2015. Gjithashtu, Komisioni ka kryer korrigjimin e formulës në ndryshimin e likuiditeteve në vitin 2014, përkatës, çka, gjithashtu, ka sjellë një përmirësim të balancës negative në vlerën 1.273.761 lekë.
100. Sa i përket pretendimit të subjektit, për të mos përfshirë në analizën financiare llogarinë e depozitës në emër të shtetasit A. H., nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit, ka rezultuar se kjo depozitë është krijuar pjesërisht përgjatë periudhës së bashkëjetesës së tij me vajzën e subjektit dhe pjesërisht jashtë saj, por gjithsesi brenda periudhës së rivlerësimit. Gjithashtu, ka rezultuar se depozita në fjalë ka vijuar të qëndrojë e investuar deri në vitin 2021 dhe, më pas, është përdorur si garanci për marrjen e një kredie bankare nga A. H. dhe vajza e subjektit, për blerjen e një apartamenti banimi në Sarandë. Nisur nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se pavarësisht faktit se depozita ka qenë pasuri e z.A. H., prej saj ka përfituar, gjithashtu, vajza e subjektit, përderisa depozita është përdorur për blerjen e banesës në emër të të dyve. Ndonëse subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e depozitës në fjalë të ardhurat nga emigracioni të z. A. H., trupi gjykues çmon se për sa kohë nuk u provuan me dokumentacion ligjor, nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare, për sa kohë mbeten në nivel deklarativ.
101. Gjithashtu, pavarësisht se z. A. H. nuk ka pasur detyrim për deklaram, duhet të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të kësaj depozite në origjinë. Lidhur me argumentin e dhënë nga subjekti, se mosdeklarimi i kursimeve të vajzës në vlerën 1.000.000 lekë nuk është kryer, pasi nuk ka qenë në rrethin e personave të lidhur për shkak të shkëputjes nga familja, nuk qëndron, pasi: (i) deri në vitin 2013, kur pretendohet të jenë krijuar kursimet në fjalë, vajza e subjektit ka jetuar me prindërit e saj dhe ka qenë subjekt deklarimi, në cilësinë e personit të lidhur; (ii) edhe pas shkëputjes nga trangu familjar, referuar ligjit nr.9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, si dhe në të gjitha rubrikat e deklaramave dhe pasurive të dorëzuara nga subjekti, ky i fundit ka pasur detyrimin për deklaram edhe për pasuritë e fëmijëve madhorë të tij. Për më tepër, duke filluar nga viti 2008, deklaramat periodike kanë pasur të specifikuar në rubrikat përkatëse edhe fëmijët madhorë të shkëputur nga prindërit.
102. Në përfundim të analizimeve të mësipërme, pasi janë vlerësuar si të bazuara dhe, për rrjedhojë, janë pranuar disa prej pretendimeve të subjektit, analiza financiare e vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit ka rezultuar më balancë negative në vlerën 1.853.111 lekë. Trupi gjykues, nisur nga pretendimet e subjektit, ka kryer edhe analizën alternative, duke

marrë në analizë dhe konsideratë si burim, për pagesat e kryera nga vajza, në vlerën prej 2.000.000 lekësh, vetëm të ardhurat e vajzës së tij. Nga kjo analizë, nisur nga momenti i porosities së apartamentit në fjalë, në vitin 2011, për këtë pasuri do të rezultonte, gjithsesi, një mungesë e burimeve të ligjshme financiare, ndonëse më e ulët, në vlerën prej 1.039.432 lekësh. Kësisoj, në çdo rast, edhe nëse do t'i qëndrohej versionit dhe pretendimit të subjektit, për analizë të vetëm pjesës takuese të vajzës – ndonëse jo i bazuar – balanca negative që rezulton nuk do të mund të përmbyste konkluzionin për pamjaftueshmërinë financiare për këtë pasuri dhe, për rrjedhojë, edhe vlerësimin përfundimtar të arritur nga Komisioni, në një vlerësim tërësor dhe me një ndërthurje edhe me konstatimet e tjera.

#### **5. Apartament banimi me sip. 71 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, në pronësi të bashkëshortes së subjektit R. B.**

103. Nga shqyrtimi i dokumentacionit<sup>52</sup> të administruar përgjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2017 bashkëshortja e subjektit, znj. R. B., ka deklaruar një apartament banimi me sip. 71 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, i ndodhur në rrugën “\*\*\*”, Tiranë<sup>53</sup>, të regjistruar në emrin e saj.
104. Nga ZVRPP-ja Tiranë<sup>54</sup> është konfirmuar se në emër të znj. R. B., në datën 26.7.2017, është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasuria me të dhënat e përshkruara më sipër, me pjesë pakuese 100%. Në dokumentacionin e përcjellë nga ky institucion ka rezultuar edhe një dëshmi e trashëgimisë testamentare me nr. \*\*\*, datë 14.4.2017, për të ndjerin T. A.<sup>55</sup>, si dhe një testament noterial me nr. \*\*\* rep., datë 4.9.2013.
105. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të sipërcituar është konstatuar se testamentlënësi ka shprehur vullnetin e tij në testament për trashëgiminë/përfitimin e pasurisë me të dhënat e përshkruara më sipër, vetëm nga vajza e tij R. B., duke përjashtuar trashëgimtarët e tjerë nga kjo pasuri. Ndërsa për të gjitha pasuritë e tjera të tij, ai ka shprehur vullnetin që të ndaheshin në pjesë të barabartë mes gjithë trashëgimtarëve, pa përjashtuar askënd prej tyre.
106. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni, në sistemin multifunksional të ASHK-së, ka rezultuar se shtetasi T. A., babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ka pasur të regjistruar në pronësi<sup>56</sup> të tij pasurinë me të dhënat e sipërcituara, të përfituar nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 1.6.2012, nga shtetasi A. V. dhe A. K. (V.), kundrejt çmimit 9.585.000 lekë, vlerë e cila është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Pasuria në fjalë është regjistruar më pas, në datën 26.7.2017, në emër të znj. R. B., në masën 100%.

<sup>52</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., e datës 16.3.2018, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Tiranë.

<sup>53</sup>Nga certifikata e pronësisë së kësaj pasurie ka rezultuar se pasuria ndodhet në rrugën “\*\*\*”, ndërkohë që në sistemin multifunksional të ASHK-së, pasuria me të njëjtat të dhëna, aktualisht, shfaqet e regjistruar në rrugën “\*\*\*”. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar se mund të bëhet fjalë për ndonjë lapsus, pasi vendndodhja e saktë është rruga “\*\*\*”.

<sup>54</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2018.

<sup>55</sup>Vjehri i subjektit të rivlerësimit.

<sup>56</sup>Si dhe disa pasuri të tjera të llojit “tokë arë”, të ndodhura në Gjirokastër.

107. Nisur nga fakti që pasuria e blerë nga vjehri i subjektit të rivlerësimi, në datën 1.6.2012, i nënshtrohej *ex lege* regjimit pasuror që buron nga martesë, Komisioni e ka ftuar subjektin nëpërmjet pyetësorit nr. 4, të paraqesë shpjegime dhe dokumentacionin ligjor lidhur me transferimin në emër të bashkëshortes së subjektit, edhe të pjesës takuese prej 50% që i përkiste vjehrrës së tij, znj. S. A. të pasurisë në fjalë, që mund të kishte mundësuar më pas regjistrimin e pasurisë vetëm në emër të znj. R. B.
108. Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti është shprehur se trashëgimlënësi ka disponuar me testament pjesën e pasurisë në pronësi të tij, duke ia kaluar vajzës së tij R. B. Ai ka sqaruar se duke qenë se prona ishte e regjistruar vetëm në emër të trashëgimlënësit, regjistrimi është bërë në emër të trashëgimtares testamentare. Ai ka deklaruar se pavarësisht gabimeve në regjistrim, bashkëshortja e tij nuk e ka mohuar asnjëherë pronësinë e nënës së saj, të fituar si bashkëshorte e të ndjerit nga përcaktimet e Kodit të Familjes, në pjesë takuese ½ të pasurisë.
109. Pasi është pyetur nga Komisioni se nga kush është përdorur kjo pasuri përpara vitit 2017, subjekti ka bërë me dije se kjo banesë u ishte dhënë me qira disa studentëve. Ndërsa pas çeljes së dëshmisë testamentare, është përdorur nga znj. I. B., vajza e subjektit, dhe nga bashkëjetuesi i saj, z. J. S., me dakordësinë e bashkëpronarëve S. A. dhe R. B. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës librezën e ujit të pijshëm dhe të energjisë elektrike të kësaj pasurie, të cilat janë në emër të znj. R. B. dhe evidentohen pagesa duke filluar nga shtatori i vitit 2018.
110. Gjithashtu, përgjatë hetimit administrativ nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2022, drejtuar FSHU-së dhe shkresës nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2022, drejtuar UKT-së, Komisioni ka kërkuar nga këto institucione administrimit e informacionit në lidhje me faturimet dhe pagesat për energji elektrike dhe ujë të pijshëm për apartamentin e sipërcituar (përfshirë ndryshimet e mundshme të matësve/përdoruesve të tij), për periudhën duke filluar nga viti 2012 e në vijim.
111. Në përgjigje të shkresave të sipërcituara, FSHU-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2022 dhe UKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022, kanë bërë me dije se kontratat për furnizimin për këtë apartament deri në muajin janar të vitit 2018 kanë qenë në emër të shtetasit I. V.<sup>57</sup>. Pas kërkesave për ndryshim, të paraqitura nga znj. R. B. (përfaqësuar nga vajza, znj. I. B.), kontratat janë lidhur në emër të saj<sup>58</sup>.
112. Megjithëse subjekti ka pretenduar se regjistrimi i kësaj pasurie, vetëm në emër të bashkëshortes së tij, mund të ketë qenë pasojë e ndonjë gabimi të mundshëm nga ana e nëpunësit të regjistrimit, nuk ka rezultuar që të jenë ndërmarrë masa nga subjekti apo nga bashkëshortja e tij për korrigjimin dhe përshtatjen e regjistrimit me kuotat nga 50% për secilën nga bashkëpronaret *de jure*.
113. Në këto kushte, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon mënyrën dhe kohën e kryerjes së pagesës/pagesave nga testamentlënësi, për blerjen e kësaj pasurie, dokumentacionin që provon burimin e tij të ligjshëm të të

<sup>57</sup>Nga historiku i pasurisë në fjalë, z. H. V. ka qenë kryefamiljari dhe babai i shitësve aktualë A. H. V. dhe A. H. V.

<sup>58</sup>Kontrata me FSHU-në ka rezultuar e lidhur në emrin e saj në muajin shkurt të vitit 2018.

ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e saj, si dhe të bëjë me dije mbi vendbanimin e tij ndër vite, duke saktësuar në emër të kujt kanë qenë të regjistruara banesat, si dhe të drejtat e tyre reale *de jure* në marrëdhëniet respektive.

114. Nga shqyrtimi dhe analizimi i sa më sipër, si dhe i dokumenteve dhe shpjegimeve të administruara, Komisioni konstatoi mungesën e një logjike ekonomike lidhur me investimin e kryer prej babait të bashkëshortes së subjektit në këtë pasuri, për sa kohë ka rezultuar se: (i) ai (dhe familja e tij) nuk kanë banuar ndonjëherë në Tiranë apo në këtë apartament; (ii) nuk ka rezultuar ndonjë dokumentacion që të provojë dhënien me qira të këtij apartamenti<sup>59</sup> apo realizimin e ndonjë përfitimi monetar nga ky send; (iii) lënia e kësaj pasurie, nëpërmjet testamentit, vetëm dhe ekskluzivisht në favor të bashkëshortes së subjektit – duke përjashtuar të gjithë trashëgimtarët e tjerë – nuk duket se ka një arsye bindëse/justifikuese; (iv) pas blerjes nga testamentlënësi, apartamenti është përdorur vetëm nga vajza e subjektit; (v) regjistrimi i kësaj pasurie, më pas, 100% vetëm në emër të bashkëshortes së subjektit, duke anashkaluar kështu, jo vetëm trashëgimtarët e tjerë të trashëgimlënësit (për shkak të testamentit, që gjithsesi nuk mund të kapërcente pragun e 50% të të drejtave reale të kësaj pasurie) – por duke përfituar (në mënyrë të pashpjegueshme dhe jologjore) edhe të drejtat reale prej 50% të kësaj pasurie që i përkisnin *de jure* vjehrrës së subjektit; (vi) ky përfitim, veç të tjerash, ka privuar sërish (dhe padrejtësisht) edhe trashëgimtarët e tjerë të nënës së bashkëshortes së subjektit, nga e drejta për të përfituar në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të saj, të ardhshëm, edhe pjesët takuese të kësaj pasurie (50%), për sa kohë që nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit nuk ka rezultuar ndonjë dokument apo deklaratë e tyre mbi heqjen dorë (hipotetike) nga trashëgimia në fjalë.
115. Dinamika e lartpërshkruar nuk gjen një logjikë shpjeguese, sikurse mbetet i paqartë, dhe gjeneron dyshime edhe fakti i kapërcimit të kufirit të masës së të drejtave reale të disponueshme, si nga testatori ashtu edhe nga zyra e ASHK-së, pasi objekti i veprimit juridik, sikurse çdo veprim tjetër që tjetëron të drejta apo sende, kufizohet dhe prodhon efekte vetëm dhe brenda sferës së të drejtave reale të disponueshme nga personi që vepron. Dhe në këtë rast, testamentlënësi dispononte jo më shumë se 50% e të drejtave reale të apartamentit në analizë, për shkak se gjysma tjetër i përkiste dhe ende sot duhet t'i përkasë nënës së bashkëshortes së subjektit dhe jo babait të saj, të ndjerë. Por, çuditërisht në këtë rast, paqartësisë apo tejkalimit të kuotës së disponueshme nga testamentlënësi i është mbivendosur veprimi i paligjshëm i ASHK-së që, në një formë ende më pak ligjore e përfundimtare, në kuptimin e pasojave juridike *de facto*, ka regjistruar dhe ka lëshuar certifikatë pronësie në masën 100% të këtij apartamenti në emër të bashkëshortes së subjektit, ndërkohë që asaj i përket vetëm 50% e të drejtave reale në fjalë.
116. Në këtë këndvështrim, si dhe në optikën e dispozitave të ligjit nr. 84/2016 të sipërcituara, (edhe nëse nuk do të kishte dyshime mbi fshehje të pasurisë në fjalë), duket se veç problematikave të testamentit, për të cilin janë shprehur më sipër dyshimet përkatëse,

---

<sup>59</sup>Nga FSHU-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2022 është vënë në dispozicion dokumentacioni, i cili provon se për këtë apartament ka pasur konsumim të energjisë elektrike nga viti 2012 e në vijim.

gjithashtu, *de facto* do të gjendeshim përballë një dhurimi të heshtur të kryer nga vjehrra e subjektit sa i takon pjesës së saj prej 50%, mbi këtë pasuri. Nisur nga të gjitha rrethanat faktike të lartpërmendura, Komisioni ka vlerësuar të nevojshëm dhe legjitim hetimin dhe verifikimin e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë në analizë<sup>60</sup>.

117. Nga hetimi administrativ<sup>61</sup> i kryer nga Komisioni ka rezultuar se vjehri i subjektit të rivlerësimit është trajtuar me pension pleqërie për periudhën prill 1994 – nëntor 2016, kur ka ndërruar jetë, me masë përfundimtare pensioni 9.542 lekë/muaj. Ndërsa vjehrra e subjektit të rivlerësimit është trajtuar me pension pleqërie prej muajit shkurt 2000 e në vijim, me masë aktuale 16.599 lekë/muaj.
118. Nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2021, Komisioni ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë të dhëna nga regjistri noterial mbi akte të mundshme noteriale lidhur me transaksione me pasuri të paluajtshme, të kryera nga prindërit e bashkëshortes së subjektit, S. dhe T. A. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2021, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar të regjistruara nga ndonjë noter, kontrata noteriale që të kenë lidhje me kalimin/tjetërsimin e pasurive të paluajtshme në emër të tyre.
119. Nga përgjigjet e dërguara nga bankat e nivelit të dytë nuk ka rezultuar ndonjë tërheqje fondesh prej prindërve të bashkëshortes së subjektit, ndër vite, përveç depozitimeve të kryera prej vjehrrit të subjektit në një depozitë me afat në “Raiffeisen Bank”, në shumën rreth 1.100.000 lekë, depozitë kjo e cila ka vijuar të qëndrojë e investuar edhe pas blerjes së pasurisë në fjalë dhe, për rrjedhojë, nuk mund të kishte shërbyer si burim për pasurinë në analizë.
120. Me anë të pyetësorit nr. 5, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor për të provuar kohën dhe kryerjen e pagesës/pagesave të çmimit të blerjes së pasurisë në fjalë dhe burimin/mundësinë financiar/e të prindërve të bashkëshortes së tij për blerjen e saj. Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se nuk disponon asnjë dokumentacion në lidhje me mënyrën e përfitimit nga shtetasi T. A., të pasurisë në analizë, por disponon vetëm procesverbalin e çeljes së trashëgimisë dhe aktin e pronësisë të lëshuar nga ASHK-ja Tiranë.
121. Ndonëse të dhënat e përcjella nga ISSH-ja përmbajnë vetëm masën e pensionit të pleqërisë aktuale ose përfundimtare – të cilat sigurisht kanë qenë edhe më të ulëta ndër vite nga dalja e tyre në pension e deri në muajin qershor të vitit 2012, kur është blerë pasuria në fjalë – duke konsideruar faktin që pensioni i pleqërisë është një ndihmë e

---

<sup>60</sup>Në nenin 77, germa “b” e Kodit të Familjes parashikohet se pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është: “[...] Pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë”. Nga ky parashikim ligjor, i cili e përjashton subjektin nga bashkëpronësia, rezulton se prindërit e bashkëshortes së subjektit nuk mund të konsiderohen persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, por referuar jurisprudencës së Kolegjit, në vendimin nr. 21 (JR), datë 10.9.2020: “... ky detyrim ligjor që i përket subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të cenohet apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni apo Kolegji për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14, e këtij ligji”.

<sup>61</sup>Kërkuar informacion me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2021, ISSH-së, e cila ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2021.

dhënë nga shteti për personat jo ekonomikisht aktivë për shkak të pleqërisë, për mbulimin e shpenzimeve minimale të jetesës, Komisioni nuk vlerësoi hetimin më tej lidhur me të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit nga pensioni i pleqërisë dhe shpenzimet përkatëse, për sa kohë rezultojnë qartësisht që nga ky burim nuk mund kurseheshin prej tyre shumat e investuara në pasurinë (objekt i testamentit) në analizë dhe nuk janë evidentuar (as nga subjekti i rivlerësimit) burime financiare alternative.

122. Megjithatë, nga një përlllogaritje e kryer me aq të dhëna sa disponohen nga Komisioni, duket se edhe nëse do të konsideroheshin maksimalisht masat përfundimtare të pensioneve të pleqërisë së prindërve të bashkëshortes së subjektit, ato sërish do të arrinin në një vlerë të përafërt me shpenzimet e jetesës të përlllogaritura për një familje me 2 persona<sup>62</sup>, duke mos rezultuar ndonjë mundësi kursimi nga të ardhurat nga pensionet, e cila do të mund të arrinte të ndryshonte apo ndikonte<sup>63</sup> në rezultatin e konstatuar mbi pamundësinë e burimeve të ligjshme financiare, në masën totale të çmimit të blerjes së pasurisë në analizë.
123. Në përfundim të sa më sipër, në lidhje me këtë apartament, nga hetimi administrativ ka rezultuar se:
  - a. Z. T. A. (testatori) dhe familja e tij nuk ka pasur mjaftueshmëri të të ardhurave të ligjshme financiare për blerjen e pasurisë apartament në analizë.
  - b. Z. T. A. ka përpiluar një testament në favor të vajzës së tij, 1 vit pas blerjes së apartamentit, duke disponuar për 100% të pasurisë, në kapërcim të masës së disponueshme – ndërkohë që pasuria ishte nën regjimin martesor, duhet që ai të dispononte vetëm për 50% të saj. Në këtë mënyrë janë përjashtuar nga trashëgimia të gjithë trashëgimtarët e tjerë ligjorë, të cilët, pavarësisht vullnetit të shprehur nga testamentlënësi, ata *de jure* do të trashëgonin pjesën takuese të bashkëshortes (nënës së tyre), në masën 50%.
  - c. Mbetet pa logjikë ekonomike dhe e paqartë arsyeja e investimit në një pasuri të paluajtshme në qytetin e Tiranës, nga z. T. A., për sa kohë nuk kishte mjete financiare dhe investimi duket alogjik dhe nuk përputhet me nevojat përkatëse, pasi as nuk ka prodhuar ndonjë përfitim në kohën e ndërmjetme nga blerja prej vjehrrit të subjektit deri në ekzekutimin e testamentit të lënë nga ky i fundit.
  - d. Z. T. A. dhe familja e tij jetonin në Gjirokastër, ndërsa vajza e subjektit, znj. I. B., kishte shkuar me studime në qytetin e Tiranës dhe duket se kjo e fundit është e vetmja që e ka përdorur pasurinë në fjalë.
  - e. Sipas dokumentacionit të administruar nga FSHU-ja rezultojnë se në këtë apartament ka pasur konsum energjie nga çdo muaj, përgjatë gjithë periudhës që ka qenë në pronësi

---

<sup>62</sup>Konkretisht, duke nisur një përlllogaritje për periudhën 2000 – maj 2012 (meqenëse pasuria është blerë në datën 1.6.2012), të ardhurat nga pensionet edhe duke konsideruar variantin me masat e vitit 2016 (të dhënat e të cilave janë marrë nga lëvizjet bankare në ABI Bank, vit në të cilin pensionet e tyre janë kredituar nëpërmjet bankës, përkatësisht 9.540 lekë dhe 14.785 lekë) do të arrinin në një vlerë prej 3.585.315 lekësh, ndërsa shpenzimet e jetesës për një familje me 2 persona, referuar të dhënave zyrtare të INSTAT-it, do të rezultojnë në masën totale prej 3.087.556 lekësh.

<sup>63</sup>Qëndrim ky i mbajtur edhe nga Kolegji në vendimin nr. 13/2020 (JR), datë 8.7.2020.

të vjehrrit të subjektit, ashtu si dhe në vijim kur ka kaluar në pronësi të bashkëshortes së subjektit.

124. Si rrjedhojë e këtyre konstatimeve, duket se veprimet e mësipërme të regjistrimit të kësaj pasurie në emër të babait të bashkëshortes së subjektit dhe kalimi më pas i të drejtave reale lidhur me të, me anë të testamentit në emër të kësaj të fundit, si dhe përdorimi nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit (vajza e subjektit), mungesa e burimit të ligjshëm të prindërve të bashkëshortes së tij për blerjen e kësaj banese – janë kryer me qëllim fshehjen e investimit në këtë pasuri nga subjekti/personi i lidhur, si dhe rrjedhimisht evitimin e verifikimeve mbi burimin e ligjshëm të përdorur për përfitimin e këtij apartamenti në vlerën 9.585.000 lekë.

125. Nisur nga sa ka rezultuar më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të paraqesë shpjegime si dhe i ka kaluar barrën e provës, lidhur me:

➤ *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur prova dhe/apo argumente për të provuar qëllimin e investimit dhe mbi mundësinë financiare, lidhur me burimet e ligjshme në investimin e kryer prej babait të bashkëshortes së tij për krijimin e pasurisë apartament në analizë.*

➤ *Ngrihen dyshime të arsyeshme se kjo pasuri ka qenë një pronësi e fshehur e subjektit të rivlerësimit, prej blerjes nga vjehri i tij, për sa kohë ka rezultuar se: (i) ky i fundit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të blerë këtë apartament dhe nuk ka banuar ndonjëherë aty; (ii) nuk ka rezultuar ndonjë dokumentacion që të provojë dhënien me qira të këtij apartamenti apo realizimin e ndonjë përfitimi monetar nga ky send; (iii) lënia e kësaj pasurie nëpërmjet testamentit, vetëm në favor të bashkëshortes së subjektit – duke përjashtuar të gjithë trashëgimtarët e tjerë – nuk duket se ka një arsye bindëse/justifikuese; (iv) pas blerjes nga testamntlënësi, përdorimi të këtij apartamenti duket se ka qenë vetëm prej vajzës së subjektit; (v) regjistrimi i kësaj pasurie, më pas, 100% vetëm në emër të bashkëshortes së subjektit, duke anashkaluar kështu - jo vetëm trashëgimtarët e tjerë të trashëgimlënësit (për shkak të testamentit, që gjithsesi nuk mund të kapërcente pragun e 50% të të drejtave reale të kësaj pasurie) – por duke përfituar (në mënyrë të pashpjegueshme) edhe të drejtat reale prej 50% të kësaj pasurie që i përkisnin de jure vjehrrës së subjektit; si dhe (vi) ky përfitim, veç të tjerash, duket se ka privuar edhe trashëgimtarët e tjerë të nënës së bashkëshortes së subjektit – nga e drejta për të përfituar në cilësinë trashëgimtarëve të saj të ardhshëm ligjorë edhe pjesët takuese të kësaj pasurie, për sa kohë që nga dokumentacioni i administruar përgjatë hetimit nuk ka rezultuar ndonjë dokument/deklaratë e tyre, për heqjen dorë nga trashëgimia.*

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

126. Për sa i përket testamentit dhe mënyrës së caktimit të trashëgimtarëve nëpërmjet tij, subjekti ka cituar dispozitat e Kodit Civil, që rregullojnë trashëgiminë testamentare – duke prapësuar dyshimet për fshehje pasurie të ngritura nga Komisioni, me argumentet si vijon:

- a. Testamenti është i vlefshëm, i lëshuar në zbatim të ligjit, nuk rezulton ndonjë kundërshti në raport me përmbajtjen dhe është nxjerrë dëshmia e trashëgimisë nga noteri.
  - b. Përcaktimi i trashëgimtarëve në testament është në dëshirën e testatorit dhe në rastin konkret nuk pa pasur asnjë pengesë ligjore apo të ndonjë forme tjetër presioni.
  - c. Testamenti ka qenë i hapur, fakt që tregon se nuk ka pasur për qëllim fshehjen e ndonjë të dhëne lidhur me disponimin.
  - d. Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë testatori nuk ka pasur vetëm të ardhura nga pensioni, por edhe të ardhura nga bujqësia, blegtoria dhe bletaria.
  - e. Trashëgimtarët e përjashtuar nga trashëgimia nuk kanë pasur pretendime apo konflikt gjyqësor.
  - f. Lidhur me përdorimin e apartamentit pas blerjes prej testatorit, ky i fundit ka banuar pjesërisht në Tiranë, në \*\*\*, Gjirokastër dhe në \*\*\* Gjirokastër. Posedimi i apartamentit është bërë prej tij, duke e dhënë me qira te persona të ndryshëm dhe nuk ka dijeni për përdorimin as bashkëshortja.
  - g. Përgjatë periudhës 2011 – 2014, vajza e tij I. B. ka banuar me dy studentë të tjerë, në një banesë tjetër, të marrë me qira në vlerën 15.000 lekë.
127. Në pikën 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, testamenti nuk parashikohet si akt juridik që personat, të cilët kanë lidhje pasurore me testatorin të kenë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Pjesa prej ½ pjesë e bashkëshortes së testatorit nuk është mohuar asnjëherë, ajo ka qenë poseduesja e apartamentit gjatë gjithë periudhës, nuk e ka humbur asnjëherë këtë të drejtë dhe gabimi në regjistrim nuk është korrigjuar pasi subjektit që i është mohuar e drejta nuk ka ushtruar kërkesë për rregullimin e tij. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 17.4.2022, të lëshuar nga shtetasi H. Sh., i cili ka deklaruar se ka jetuar së bashku me motrën e tij dhe vajzën e subjektit në një banesë me qira.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

128. Nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë provë apo dokument të kohës për të provuar përdorimin e kësaj pasurie nga dikush tjetër, përveç vajzës së subjektit. Po ashtu, nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të vjehrrit të tij për blerjen e kësaj pasurie dhe, për pasojë, duket se rezultatet e njoftuara subjektit për këtë pasuri nuk ndryshojnë, duke mbetur të gjitha elementet e lartpërshkruar, të cilat kanë krijuar bindjen e trupit gjykues se ky apartament është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit. Ky fakt përbën një shkelje që kualifikohet në germën “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, që çon në aplikimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 5 dhe, rrjedhimisht, edhe të pikës 3, të



nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, dispozita të cilat përcaktojnë masën e shkarkimit nga detyra.

129. Gjithashtu, mënyra e të shpjeguarit jobindës dhe qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në kohë, në raport me këtë pasuri, përfshirë këtu edhe qasjen pasive të tij dhe të bashkëshortes, edhe përgjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me mosveprimin për rregullimin e “të metave” të procesit të regjistrimit të këtij apartamenti – me qëllim korrigjimin e përshkrimit në certifikatën e pronësisë, të vetëm pjesës takuese legjitime prej 50% – përbën një rrethanë joetike për një gjyqtar, e cila do të mbahet në vëmendje në vlerësimin tërësor të subjektit në këtë aspekt.

**6. Apartament banimi me sip. 61 m<sup>2</sup>, në Sarandë, në bashkëpronësi të vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ç. B. dhe z. A. H.**

130. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. Ç. B. dhe z. A. H. kanë në pronësi të tyre një apartament banimi me sip. 61 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Lagjen Nr. \*\*\*, Sarandë.
131. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur certifikatën e pronësisë së kësaj pasurie me nr. \*\*\*, në z. k. \*\*\*, e regjistruar në bashkëpronësi me nga 1/2 pjesë secili. Në përgjigjet e tij subjekti është shprehur se si burim krijimi për këtë apartament kanë shërbyer një kredi bankare në shumën 2.950.000 lekë dhe kursimet e tyre në shumën 550.000 lekë. Pronësia mbi këtë apartament është përfituar me anë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\*, datë 9.6.2021, e nënshkruar kjo me palën shitëse V. J., kundrejt çmimit total prej 3.500.000 lekësh.
132. Gjithashtu, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë kontratën e kredisë bankare në shumën 2.950.000 lekë, si dhe dokumentacionin ligjor mbi të ardhurat që kanë mundësuar kursimin e shumës prej 550.000 lekësh. Subjekti i rivlerësimit është shprehur se kredia është marrë në bazë të garancisë së pagave të tyre dhe të ardhurave të aktivitetit privat të shtetasit A. H. “\*\*\*”. Shuma 550.000 lekë është kursyer nga të ardhurat e tyre nga paga dhe biznesi privat i bashkëjetuesit A. H. Sipas të ardhurave të deklaruara në tatime, shtetasi A. H. ka deklaruar në vitin 2020 një fitim prej 410.000 lekësh, ndërsa në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021 rreth 290.000 lekë, të cilat janë investuar në shumën 550.000 lekë për blerjen e këtij apartamenti. Subjekti ka paraqitur një kopje të kontratës së shitblerjes dhe të kredive të marra.
133. Në vijim të sa më sipër, nisur nga fakti që ka rezultuar se pasuria në fjalë është blerë dhe është likuiduar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, burimet financiare të përdorura për këtë pasuri rrjedhin nga kredia bankare, si dhe të ardhura të realizuara gjithashtu pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* – bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>64</sup> – Komisioni ka vlerësuar se nuk kishte arsye për kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme dhe për analizimin e detajuar të burimit të krijimit të pasurisë në fjalë, për sa kohë ato nuk ndërthuren me periudhën e rivlerësimit.

---

<sup>64</sup>Vendimi nr. 8/2021 (JR).

## 7. Automjet tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 600.000 lekë

134. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2010 dhe në deklaratën *Vetting* kontratën e shitblerjes me nr. \*\*\*, datë 5.5.2010, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*<sup>65</sup>, nga shtetasi A. Q., në vlerën 600.000 lekë. Në lidhje me burimin për krijimin e kësaj pasurie ka deklaruar se këtë automjet e ka blerë me të ardhurat e familjes.
135. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni ka administruar<sup>66</sup> dosjen e automjetit në fjalë, nga DPSHTRR-ja<sup>67</sup>, nga shqyrtimi i së cilës ka rezultuar se ky automjet është blerë fillimisht nga shtetasi A. Q.<sup>68</sup> në vlerën 1.000.000 lekë<sup>69</sup>, nëpërmjet kontratës nr. \*\*\*, datë 3.4.2008, ndërkohë që subjekti e ka përfituar rreth 2 vjet më pas në vlerën 600.000 lekë.
136. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare<sup>70</sup> ka informuar Komisionin se në periudhën 2012 – 2017, subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me të dhënat e sipërcituara. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer nga Komisioni, në sistemin informatik të këtij institucioni, nuk ka rezultuar që subjekti të ketë qenë përdorues i automjeteve të tjera, veç atij të deklaruar në pronësi të tij.
137. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, lidhur me çmimin e blerjes në masën afërsisht sa 1/2 e çmimit që shitësi e kishte përfituar 2 vite më herët, subjekti ka deklaruar se automjeti ishte amortizuar dhe çmimi i blerjes nga ana e tij është brenda logjikës ekonomike të tregut.

### 7.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

138. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë me dije se për blerjen e automjetit në analizë, ka përdorur vlerën 300.000 lekë nga kursimet dhe vlerën 300.000 lekë nga shuma e kthyer nga z. A. B., në këmbim të shitjes së letrave me vlerë.
139. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar një deklaratë noteriale me nr. \*\*\*, të datës 12.12.2014, të lëshuar nga shtetasi A. B., i cili është shprehur se ka marrë në vitin 2004 shumën 300.000 letër me vlerë, të cilat i ka kthyer në fillim të vitit 2011.
140. Më pas, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në të cilin subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumentacionin ligjor që provon kthimin pas të shumë prej 300.000 lekësh – subjekti ka paraqitur një deklaratë tjetër noteriale me nr. \*\*\*, datë 3.11.2021, në të cilën shtetasi A. B. është shprehur se letrat me vlerë i ka marrë nga z. Guximtar Boçi në vitin 1995 dhe i ka kthyer në vitin 2010 shumën 300.000 lekë.

<sup>65</sup>Aktualisht automjeti mban targën \*\*\*.

<sup>66</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2020.

<sup>67</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017.

<sup>68</sup>I pyetur nga Komisioni në lidhje me marrëdhënien me shtetasin A. Q., subjekti ka deklaruar se me këtë shtetas, përveç marrëdhënies shitës dhe blerës, automjeti nuk ka asnjë marrëdhënie tjetër të çdolloji. Në përgjigje të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2021, të dërguar nga Komisioni, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2021, është bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, ku palë të ketë qenë shtetasi A. Q.

<sup>69</sup>Referuar deklaratës doganore të datës 7.4.2008 është paguar tarifa doganore nga z. D. K. në vlerën 588.860 lekë.

<sup>70</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2020.

141. Përpos mospërputhjeve midis deklarimeve të z. A. B., sa i përket kohës së marrjes së letrave me vlerë dhe kohës së kthimit të shumës monetare, Komisioni ka konstatuar gjithashtu se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë nga deklaratat e tij periodike prej vitit 2003 e në vijim, shumën e dhënë në huadhënie dhe as kthimin pas të saj. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion të kohës për të provuar dhënien dhe marrjen pas të shumës monetare. Për më tepër, kjo hua nuk është deklaruar si burim për këtë pasuri, as në deklaratën e vitit 2010 dhe as në atë *Vetting*, për pasojë Komisioni nuk e ka konsideruar atë si të ardhur në analizën e kësaj pasurie.
142. Në të gjitha rastet, siç është evidentuar edhe më herët, duket se mungon legjitimiteti i dhënies së letrave me vlerë prej subjektit të rivlerësimit, për sa kohë këto letra kanë qenë në emër të babait të subjektit dhe referuar dispozitave ligjore në fuqi, duhet të ishin ndarë mes gjithë trashëgimtarëve.
143. Në këto kushte, edhe sikur të ishte provuar momenti i dhënies së huas dhe momenti i kthimit të saj, si dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave që kanë mundësuar kthimin nga huamarrësi – për të cilat edhe në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion provues – sërish masa që do t'i takonte subjektit nga kjo shumë, pas ndarjes mes trashëgimtarëve, do të ishte vetëm 1/4<sup>71</sup> e saj, 75.000 lekë.
144. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të familjes së subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se nga fillimi i vitit 2010 e deri në datën 5.5.2010, kur është blerë automjeti, është tërhequr *cash* në total shuma 360.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2010, prej subjektit nuk është deklaruar pakësim i kursimeve të disponuara *cash* në banesë, të cilat referuar deklarimeve ndër vite, kanë qenë në masën 50.000 lekë.
145. Rrjedhimisht, Komisioni ka përlllogaritur edhe shpenzimet e familjes për një periudhë 4-mujore, në përfundim të së cilës ka rezultuar se për kryerjen e investimit në këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej – 427.018 lekësh, sipas detajimit në tabelën vijuese.

|  |                  |
|--|------------------|
| Të ardhura nga paga 1.1.2010 - 5.5.2010  | 360 000          |
| Shpenzim për blerjen e automjetit        | - 600 000        |
| Shpenzime të periudhës 1.1.2010-5.5.2010 | - 187 018        |
| <b>Rezultati</b>                         | <b>- 427 018</b> |

146. Nisur nga sa më sipër, për këtë pasuri Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime në lidhje me këto konkluzione:

➤ *Duket se ka mospërputhje midis deklarimeve të huamarrësit A. B. në deklaratat noteriale të viteve 2016 dhe 2021, sa i përket kohës së marrjes dhe kohës së kthimit të huas.*

➤ *Duket se për kryerjen e investimit në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën 427.018 lekë.*

<sup>71</sup>Për sa kohë dhe nëna e subjektit gjithashtu ka ndërruar jetë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

147. Lidhur me analizën financiare të periudhës 5-mujore të vitit 2010, subjekti ka pretenduar se duhet të përfshihet edhe kthimi i vlerës së dhënë nga z. A. B., prej 300.000 lekësh, pasi në vitin 1995 ka marrë letra me vlerë për privatizimin e truallit të objektit ish-NPV Gjirokastër, për të cilën ai ka bërë edhe një deklaratë noteriale.
148. Shtetasi A. B. i ka dhënë deklaratimet para noterit ku ka sqaruar çdo detaj lidhur me këtë fakt dhe është i gatshëm të japë dëshminë e tij kudo që mund të thirret për të deklaruar lidhur me vlerën e kthyer në vitin 2010. Lapsusi që ka bërë në deklarinimin e parë se i ka marrë letrat me vlerë në vitin 2004 vjen për shkak të moshës së tij. Provat e paraqitura vërtetojnë se letrat me vlerë janë marrë në vitin 1995 dhe janë paguar po në këtë vit për blerjen e truallit të privatizuar, ndërsa kthimi i vlerës huadhënësit është bërë në vitin 2010.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

149. Fillimisht vërehet se z. A. B., në vitin 2014, ka bërë një deklaratë noteriale, ku ka deklaruar se këtë shume ia ka kthyer subjektit në fillim të vitit 2011, pasi e kishte marrë në formën e letrave me vlerë, në vitin 2004. Ndërkohë që, në deklarinimin e dytë, që ka dhënë para noterit në vitin 2021, shtetasi A. B. ka pohuar se këtë shumë ai e kishte marrë në vitin 1995 dhe e ka kthyer në vitin 2010. Përballë dy versioneve të ndryshme, vlerësohet se nisur edhe nga jurisprudenca e Kolegjit, si dhe nga praktikat e Komisionit, vlera më e madhe provuese dhe bindëse në këtë rast i përket deklarinimit të kryer përpara nisjes së procesit të rivlerësimit dhe jo asaj të paraqitur përgjatë këtij procesi.
150. Gjithsesi, në lidhje me këtë burim/pretendim, përpos mospërputhjeve si më lart, mbi periudhat e deklaruara të marrjes dhe kthimit të huas nga shtetasi A. B., duhet mbajtur në vëmendje se referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. A. B. duke qenë se ka pranuar huamarrjen, ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 300.000 lekësh të kthyer subjektit.
151. Për sa kohë subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar sa më sipër, ky burim i pretenduar ka mbetur i paprovuar edhe lidhur me burimin e ligjshëm të huamarrësit, përtej mosprovimit të marrjes dhe disponimit të kësaj shume nga subjekti në vitin 2010. Kësisoj, në mungesë të provës mbi dinamikën e kësaj marrëdhënieje lidhur me kohën e kthimit, si dhe me burimin e ligjshëm, pretendimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ dhe, rrjedhimisht, pamjaftueshmëria e mjeteve monetare për këtë pasuri mbetet në masën 427.018 lekë.

### **8. Depozitë bankare në vlerën 2.356.056 lekë, në “Alpha Bank”**

152. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një depozitë bankare në “Alpha Bank”, të krijuar nga të ardhurat e përfituara si dëmshpërblim nga statusi i ish-të përndjekurit politik nga depozita në “Raiffeisen Bank” dhe shtesat ndër vite.
153. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se kjo depozitë është e krijuar nga transfertat e shumës 2.213.000 lekë, e datës 28.8.2013, nga llogaria e subjektit në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e tij në “Alpha Bank”.

154. Kjo shumë është krijuar nga shumat e mëposhtme, si dhe është shtuar me të ardhurat nga interesat ndër vite, si vijon:
- shuma prej 300.000 lekësh e depozituar prej subjektit, nga të cilat 100.000 lekë përpara vitit 2003 në ish-Bankën e Kursimeve dhe 200.000 lekë në datën 25.10.2005, në “Raiffeisen Bank”;
  - shuma prej 850.660 lekësh e transferuar në datën 14.6.2011;
  - shuma prej 850.660 lekësh e transferuar në datën 1.8.2013.
155. Përgjatë hetimit administrativ, nga Ministria e Financave<sup>72</sup>, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2017, është bërë me dije se z. Guximtar Boçi ka qenë përfaqësues në cilësinë e trashëgimtarit të radhës së parë në dosjen nr. \*\*\*, të ish-të përndjekurit politik, z. Ç. B., miratuar me VKM-në nr. 1259, datë 23.12.2009, “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuarit politikë të regjimit komunist” dhe se ka tërhequr deri në këtë datë dy këste takuese të dëmshpërblimit financiar. Në përgjigjen e ardhur me shkresën nr.\*\*\* prot., datë 31.1.2022, Ministria e Financave ka bërë me dije se në vitin 2020 është shpërndarë edhe kësti i tretë (nga tetë), me të njëjtën vlerë prej 850.660 lekësh.
156. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një njoftim me nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2008, dërguar subjektit nga Ministria e Drejtësisë, në të cilën i është kërkuar të plotësojë dhe të dërgojë pranë këtij institucioni dy formularë vetëdeklarimi mbi përfitime në të holla, në letra me vlerë dhe/ose pasuri të paluajtshme të marra në emrin e ish-të dënuarit politik me ligje të mëparshme.
157. Bazuar në këtë kërkesë, Komisioni i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për të vënë në dispozicion dosjen e plotë të babait të subjektit, z. Ç. B., së bashku me këta formularë të dorëzuar. Gjithashtu, Komisioni i është drejtuar Ministrisë së Financave për të vënë në dispozicion shumën e plotë të përfituar/për t’u përfituar, si dhe mënyrën e përlogaritjes së masës së dëmshpërblimit të miratuar.
158. Në përgjigje të sa më sipër, Ministria e Drejtësisë<sup>73</sup> ka përcjellë dosjen e z. Ç. B., sipas së cilës pjesa takuese e dëmshpërblimit ka rezultuar në vlerën 6.805.281 lekë. Përgjatë analizimit të dokumentacionit të administruar nga Komisioni ka rezultuar një mospërputhje midis asaj që shprehet në përmbajtjen e tyre, krahasuar me atë që ka shprehur subjekti në përgjigje të pyetësorëve, si vijon:
- Në deklaratën noteriale me nr. \*\*\*, datë 3.12.2014, deklaruesit F. Sh., F. P., E. B. dhe F. B. janë shprehur se heqin dorë nga pjesa e tyre takuese e dëmshpërblimit që përfitohet nga statusi i të përndjekurve politikë të babait të tyre Ç. B. duke ia lënë pjesën vëllait të tyre Guximtar Boçi.*
  - Më anë të prokurës së posaçme nr. \*\*\*, datë 17.5.2011, shtetasit e mësipërm kanë emëruar si përfaqësues Guximtar Boçin, i cili mund të paraqitet në emrin e tyre në “Raiffeisen Bank”, me qëllim tërheqjen e parave të përfituara nga statusi i të*

<sup>72</sup>Bashkëlidhur shkresës gjendet tabela e dosjes \*\*\* në emër të shtetasit Ç. B. në vlerën 1.701.320 lekë. Dëshmia e trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 1.7.2004, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, pas vdekjes së shtetasve Ç. dhe H. B., duke përcaktuar trashëgimtarët ligjorë S. B., F. Sh. (B.), F. P. (B.) dhe Guximtar Boçi, ku secili përfiton 1/4 pjesë të pasurisë.

<sup>73</sup>Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.2.2022.

*përndjekurve politike të babait të tyre Ç. B. Të përfaqësuarit deklarojnë se pjesën e tyre ia kanë lënë Guximtar Boçit, për shkak të bashkëjetesës me Ç. B.*

159. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se pjesëtimi i parave të përfituara nga dëmshpërblimi nuk është kryer pasi pritej që të përfitoheshin edhe këste të tjera, si dhe për faktin që subjekti ishte në paaftësi paguese për shkak të ndërprerjes së pagës.
160. Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, Komisioni, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimin të shpjegojë këtë mospërputhje, duke bërë me dije gjithashtu mbi shumën totale për t'u përfitur dhe duke e shoqëruar përgjigjen me dokumentacionin përkatës.
161. Subjekti, në përgjigje të sa më sipër, ka shpjeguar se kërkesa e tij i është përcjellë Ministrisë së Financave për të përlllogaritur dëmshpërblimin, i cili sipas ligjit do të paguhet në tetë këste me nga 850.000 lekë/secili. Subjekti ka bërë me dije se janë paguar tri prej kësteve, nga të cilat dy këstet e para janë tërhequr prej tij dhe janë depozituar në bankë, ndërsa kësti i tretë është depozituar në OTP Bank, në llogarinë e tij në datën 22.12.2020. Këto fonde janë tërhequr prej tij në janar të vitit 2021 dhe u janë dhënë pjesët takuese trashëgimtarëve F. Sh. dhe F. P. *cash*, ndërsa z. E. B., trashëgimtar i z. S. B., vëllait të subjektit, e ka tërhequr në llogarinë e tij pjesën takuese pasi ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm pranë drejtorisë përkatëse.
162. Subjekti ka shpjeguar se ndonëse nuk është shprehur mirë në pyetësorët e mëparshëm, trashëgimtarët e tjerë kanë hequr dorë nga dy këstet e para, ndërsa me marrëveshje kanë pritur që të kalojnë këstet e tjera për t'u shpërndarë sipas pjesës takuese të secilit trashëgimtar nga një këst, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues për marrjen e këstit të tretë, mënyrën e ndarjes së saj dhe dhënien trashëgimtarëve të tjerë. Ndërkohë, duke iu referuar dëshmisë së trashëgimisë së çelur për prindërit e subjektit janë përcaktuar trashëgimtarët e tyre, të cilët do të trashëgojnë ¼ pjesë/secili.

### **8.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

163. Nga sa më sipër, duket se nga tetë këste të dëmshpërblimit që do të përfitohen prej 850.660 lekësh/secili, pjesa takuese e subjektit duhet të ishte ¼ e saj, përkatësisht 1.701.320 lekë, të cilat subjekti i rivlerësimin i ka përfitur me dy këstet e para të kaluara në favor të tij. Ndërsa sa i përket shumës 300.000 lekë, të depozituar *cash* prej tij, përkatësisht në vitet 2001 dhe 2005, Komisioni ka kryer analizën financiare si në vijim.
164. Në pamundësi për të evidentuar momentin e depozitimit të shumës së parë prej 100.000 lekësh, Komisioni ka konsideruar investimin e saj në tetor të vitit 2001, nisur nga deklarimi i subjektit në DIPP-në e vitit 2003, ku është cituar: "*Depozitë në bankë 100.000 lekë, nr. kartës \*\*\*, data e lëshimit 15.10.2001*".
165. Komisioni ka analizuar të ardhurat dhe shpenzimet nga fillimi i vitit e deri në tetor të vitit 2001<sup>74</sup>, nga ku ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare si në vijim.

---

<sup>74</sup>Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën përpara vitit 2003 ka rezultuar se deri në vitet 1998, 1999 dhe 2000 kanë qenë me balancë negative dhe, për pasojë, nuk duket të ketë pasur kursime nga periudha të mëparshme për t'u konsideruar në analizën e vitit 2001 si të mbartura.

|   |                 |
|---|-----------------|
| Të ardhura nga paga janar-tetor 2001      | 369 910         |
| Depozitim në bankë                        | - 100 000       |
| Shpenzime të periudhës janar - tetor 2001 | - 362 880       |
| <b>Rezultati</b>                          | <b>- 92 970</b> |

166. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se shuma 200.000 lekë është depozituar prej subjektit në datën 25.10.2005. Nga shqyrtimi i deklaratës periodike të vitit 2005, subjekti ka deklaruar burimin e kësaj shtese në depozitë, me të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*.
167. Ndërkohë, nga dokumentacioni i administruar përgjatë procesit të rivlerësimit është konstatuar se ky automjet është shitur prej subjektit me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, të datës 29.1.2004. Por në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar as shitjen e automjetit dhe as kursime të disponuara *cash* në banesë, të cilat të mund të mbarteshin prej tij në vitin 2005 dhe të përdreshin më pas për depozitim e kryer. Për pasojë, ky burim nuk mund të ketë shërbyer për depozitim e kryer në tetor të vitit 2005, rreth 2 vjet pas shitjes së automjetit.
168. Megjithatë, nga analiza e kryer nga Komisioni për periudhën janar – tetor 2005, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për depozitim e shumës 200.000 lekë.

|   |                |
|---|----------------|
| Të ardhura nga paga janar-tetor 2005      | 755 529        |
| Depozitim në bankë                        | - 200 000      |
| Shpenzime të periudhës janar - tetor 2005 | - 415 190      |
| Të mbetura në llogarinë e pagës           | - 13 302       |
| <b>Rezultati</b>                          | <b>127 037</b> |

169. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit shpjegime, si dhe i ka kaluar barrën e provës në lidhje me sa vijon:
- *Duket se ka mospërputhje midis deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorëve, krahasuar me dokumentacionin e paraqitur prej tij bashkëngjitur deklaratës Vetting dhe përgjigjeve të institucioneve përkatëse për përfitimin e dëmshpërblimit.*
  - *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë lidhur me përfitimin dhe mënyrën e përlllogaritjes së dëmshpërblimit për t’u pjesëtuar prej tij dhe trashëgimtarëve të tjerë.*
  - *Duket se me aq sa disponohet nga Komisioni, nuk është e qartë ndarja e shumës së përfituar deri në deklaratën Vetting nga dëmshpërblimi. Gjithashtu, nuk duket të ketë logjikë në arsyetimin/shpjegimin e subjektit, se shkak për përfitimin total të kësteve të para të dëmshpërblimit, prej subjektit të rivlerësimit, ishte nevoja/paafhtësia e tij paguese, për sa kohë ai nuk i ka tërhequr/përdorur këto shuma nga momenti i transferimit, në qershor të vitit 2011 – kur kanë kaluar në dispozicion të subjektit – dhe deri në dhjetor të vitit 2019.*
  - *Duket se për krijimin e depozitës në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare për depozitim fillestar në vitin 2001, në shumën – 92.970 lekë.*

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

170. Subjekti ka shpjeguar se kërkesa për dëmshpërblim si i përndjekur politik i është përcjellë Ministrisë së Financave për të përlllogaritur dëmshpërblimin, i cili sipas ligjit do të paguhej në tetë këste me nga 850.000 lekë/secili. Ai ka deklaruar se janë paguar tri prej kësteve, nga të cilat, dy të parat janë tërhequr prej tij dhe janë depozituar në bankë, ndërsa kësti i tretë është depozituar në OTP Bank, në llogarinë e tij në datën 22.12.2020. Në janar të vitit 2021, fondet në fjalë janë tërhequr dhe janë shpërndarë pjesët takuese midis trashëgimtarëve F. Sh. dhe F. P., *cash*, ndërsa z. E. B., trashëgimtar i z. S.B., e ka tërhequr në llogarinë e tij pjesën takuese.
171. Lidhur me analizën financiare, subjekti ka pretenduar se nuk është dakord pasi nuk ka deklaruar se shuma 100.000 lekë është kursyer në këtë periudhë, por është akumuluar nga kursimet në vite. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një deklaratë me nr. \*\*\*, datë 17.4.2022, të trashëgimtarëve F. Sh. dhe F. P. për heqjen dorë nga përfitimi i pjesës takuese për dy këstet e përfitimit të dëmshpërblimit si të përndjekur politikë.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

172. Lidhur me analizën financiare të depozitimit të shumës prej 100.000 lekësh, nisur nga fakti që analiza financiare, duke filluar nga viti 1998 e në vijim deri në vitin 2001, është me balancë negative për secilin vit veçmas, atëherë konkludohet se në çfarëdoq momenti të ishte krijuar ajo, sërish shuma prej 100.000 lekësh do t'i shtohet balancës negative të viteve paraardhëse, përkatëse, duke mos u ndryshuar rezultatit final. Për pasojë, rezultati që i është njoftuar subjektit për këtë mungesë të burimeve të ligjshme financiare, nuk do të ndryshonte gjithsesi. Kësisoj, në këtë rast, shpërndarja e ndryshme ndër vite e këtij kursimi, edhe nëse do të përlllogaritej sipas pretendimeve të subjektit, do të çonte në të njëjtin rezultat final, të periudhës së interesuar.

### **9. Depozitë në “Societe Generale Albania”, në vlerën 300.000 lekë, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit R. B.**

173. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e personit të lidhur, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga paga në N. Rr. R. Gjirokastrë si dhe depozitë në “Societe Generale Albania” në vlerën 300.000 lekë, të krijuar nga të ardhurat nga paga dhe nga shitja e produkteve bujqësore.
174. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se kjo depozitë është çelur nga një depozitim i kryer *cash* në datën 16.4.2015, prej 211.000 lekësh dhe transferimi i gjendjes së llogarisë së pagës<sup>75</sup> prej 89.000 lekësh në të njëjtën datë.
175. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë deklaruar në disa prej DIPP-ve, të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore, konkretisht: 600.000 lekë në vitin 2009; 200.000 lekë në vitin 2012; 200.000 lekë në vitin 2013; 200.000 lekë në vitin 2014; 250.000 lekë në vitin 2015 dhe 200.000 lekë në vitin 2016. Pra, të ardhura në total 1.650.000 lekë. Ndërkohë, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura nga

<sup>75</sup>Nga ISSH-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017, është bërë me dije se shtetasja R. B. ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë së Rugëve Gjirokastrë, përgjatë periudhës prill 2013 – shkurt 2015.



shitja e prodhimeve bujqësore me fatura tatimore në vlerën 1.560.000 lekë dhe të ardhura pa faturë tatimore nga 150.000 – 200.000 lekë/vit. Në dokumentacionin bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka dorëzuar faturat si vijon:

- dëftesë tatimore nr. \*\*\*, datë 7.9.2008, shitës Guximtar Boçi, në vlerën 300.000 lekë;
- faturë e thjeshtë tatimore nr. \*\*\*, datë 18.9.2008, shitës Guximtar Boçi, në vlerën 960.000 lekë;
- dëftesë tatimore nr. \*\*\*, datë 12.9.2009, shitës Guximtar Boçi, në vlerën 300.000 lekë.

176. Nga DRT-ja Gjirokastër, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.7.2017 dhe nga DPT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2020, është konfirmuar se shtetasi Guximtar Boçi dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar të ardhura të përfituara nga toka bujqësore.
177. Përgjatë hetimit administrativ, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021, i ka kërkuar informacion Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, në lidhje me regjistrimin si fermer pranë këtij institucioni të ndonjë prej anëtarëve të familjes së subjektit.
178. Ky institucion, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2021, ka bërë me dije se asnjë prej pjesëtarëve të familjes Boçi nuk është i regjistruar si fermer pranë këtij institucioni dhe se nuk disponon asnjë informacion për sipërfaqen e tokës që zotëron subjekti apo ndonjë prej anëtarët e tjerë të familjes.
179. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një vërtetim datë 4.11.2021 nga DRSSH-ja Gjirokastër, e cila ka bërë me dije se bashkëshortja e subjektit, znj. R. B., figuron e vetëpunësuar në bujqësi nga viti 1993 dhe ka paguar kontributet përkatëse për periudhën 1993 – 2012.
180. Përgjatë hetimit administrativ, Komisioni i është drejtuar Njesisë Administrative Ç. për të bërë me dije nëse nga subjekti i rivlerësimit është paguar taksa e tokës bujqësore, si dhe të informojë lidhur me kulturat e mbjella në tokën në pronësi të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe çdo informacion të mundshëm lidhur me të ardhura dhe shpenzime të mundshme nga viti 1993 e në vijim. Ky institucion, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2022, ka bërë me dije se janë shlyer detyrimet për pagesën e tatimit të tokës bujqësore.
181. Ndonëse për bashkëshorten e subjektit janë paguar kontributet e detyrueshme si e vetëpunësuar në bujqësi – bashkëshortja e subjektit nuk rezulton e regjistruar si fermer pranë institucioneve përkatëse, nuk ka rezultuar e paguar taksa e tokës bujqësore, si dhe faturat e paraqitura të shitjes së produkteve bujqësore janë në emër të subjektit dhe jo bashkëshortes, të ardhurat e pretenduara nga shitja e produkteve bujqësore nuk janë përfshirë në analizën financiare, si të ardhura të ligjshme.
182. Për më tepër, nga verifikimi i kryer nga Komisioni në faqen zyrtare të QKB-së, ka rezultuar se NIPT-et e shënuar në dy prej faturave të paraqitura nga subjekti, nuk i përkasin blerësit të shënuar në këto fatura, duke ngritur kështu dyshime për vërtetësinë e tyre dhe të të ardhurave të pretenduara si të përfituara nëpërmjet tyre.

183. Gjithashtu, duket se pala shitëse në faturat e paraqitura është subjekti i rivlerësimit, ndërkohë që referuar nenit 143 të Kushtetutës së Shqipërisë “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*”.
184. Nga shqyrtimi i deklaratës periodike të vitit 2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar çeljen e depozitës me burim nga kursimet nga të ardhurat. Në këtë deklaratë nuk është deklaruar ndonjë pakësim i kursimeve të disponuara *cash* në banesë dhe, për pasojë, nga Komisioni është kryer analiza financiare bazuar në të ardhurat e vitit 2015, deri në datën e depozitimit, sipas detajimit në tabelën vijuese.

|   |                 |
|---|-----------------|
| Të ardhura nga paga janar - prill 2015    | 410 000         |
| Depozitim në bankë                        | - 211 000       |
| Shpenzime të periudhës janar - prill 2015 | - 251 806       |
| <b>Rezultati</b>                          | <b>- 52 806</b> |

185. Nisur nga sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime në lidhje me sa vijon:
- *Duket se të ardhurat e pretenduara si të fituara nga shitja e produkteve bujqësore nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk kanë rezultuar të provuara asnjëra prej tre elementeve të nevojshëm në mënyrë kumulative: (i) përfitimi konkret i tyre; (ii) regjistrimi si fermer i ndonjërit prej pjesëtarëve të familjes së subjektit; (iii) pagimi i taksës së tokës bujqësore.*
  - *Duket se për krijimin e depozitës në fjalë, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 52.806 lekësh.*

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

186. Lidhur me dëftesat tatimore, subjekti ka sqaruar se janë shitur prodhimet e rrushit të disa viteve të përmbledhura në një faturë tatimore pasi në atë periudhë nuk mund të sigurohej dokumentacioni i shitjes së prodhimeve.
187. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se është paguar taksa e tokës bujqësore, si dhe ka shpjeguar se faturat e paraqitura të shitjes së produkteve bujqësore janë në emër të vetë kryefamiljarit për shkak se familja bujqësore organizohet dhe përfaqësohet përmes kryetarit të familjes, parashikuar nga nenet 222-230 të Kodit Civil.
188. Lidhur me gjetjen e Komisionit se NIPT-et e shënuara në faturat tatimore, të paraqitura prej subjektit, nuk i përkasin blerëseve të shënuar në to, është shprehur se NIPT-et e subjekteve ndryshojnë në vite sipas regjistrimeve të bëra prej tyre dhe ky fakt nuk mund të vëre në dyshim faturën tatimore të lëshuar nga subjekti përkatës, i identifikuar saktësisht.
189. Subjekti ka sqaruar se në deklaratën periodike të vitit 2015, bashkëshortja e tij ka deklaruar çeljen e depozitës me burim nga kursimet nga të ardhurat, të cilat për sa kohë kanë qenë deri në vlerën 300.000 lekë, edhe mund të mos deklarohen.

## Vlerësimi i trupit gjykues

190. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në analizë të dokumentacionit të administruar, në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit nga tregtimi i produkteve bujqësore, në vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka konstatuar se gjatë kësaj periudhe ka qenë e punësuar në një sektor tjetër dhe nuk ka qenë më e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi. Referuar legjislacionit për sigurimet shoqërore në fuqi asokohe dhe aktualisht, ndër të tjera, thuhet se: *“Të vetëpunësuarit në bujqësi duhet të plotësojnë disa kushte: (a) të mos jenë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë ...”*. Rrjedhimisht, këto të ardhura të pretenduara të mbeten në nivel deklarativ pasi nuk plotësohen kushtet për konsiderimin e tyre si të provuara lidhur me krijimin e tyre, si dhe po ashtu nuk mund të kualifikohen si burim i ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për pasojë, rezultati i njoftuar subjektit për këtë pikë nuk ndryshon.
191. Sa i përket faturave tatimore, në të cilat nga Komisioni ishte konstatuar se nuk i përkisnin blerëseve të shënuar në to, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë provë për të kundërshtuar këtë gjetje apo ndonjë shpjegim bindës lidhur me shifrat e pretenduara si të realizuara. Gjithashtu, vlen të theksohet se mosdisponimi i një NIPT-i, i cili është posaçërisht numri i identifikimit të personit të tatueshëm, me të cilin subjektet tatimore verifikohen në organet tatimore – ndonëse në këtë rast fermeri nuk do t’i nënshtrohej detyrimit tatimor, por gjithsesi është tregues i gjenerimit të të ardhurave nga bujqësia/blegtoaria – përbën një tjetër element të munguar, që konfirmon pamundësimin e konsiderimit të këtyre të ardhurave të pretenduara. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk është provuar as përfitimi i shumave konkrete, në masë e në kohë të konstatueshme, as burimi i tyre realisht nga tregtimi i produkteve bujqësore, as plotësimi i kriterëve ligjore për t’u kualifikuar si “fermer” në periudhën në fjalë – në vitet 2014, 2015 dhe 2016 – të ardhurat e pretenduara nga subjekti nuk mund të konsiderohen të pranueshme si një burim i ligjshëm financiar i përfituar nga familja e tij.
192. Lidhur me pretendimin e subjektit për mbulimin e nevojave të familjes me prodhimin bujqësor, referuar edhe shpjegimeve të tij, përgjatë jetesës në fshatin \*\*\*, ka deklaruar se toka ka qenë e mbjellë me hardhi. Më pas, pas transferimit në \*\*\*, ka mbjellë një sipërfaqe toke prej 250 m<sup>2</sup>, përpara shtëpisë së banimit, me perime të ndryshme. Nga sa më sipër, duket se përpara vitit 1998, edhe sikur të konsiderohej e provuar mbjellja e tokës në \*\*\* me hardhi, vlera për t’u ulur në shpenzimet e jetesës si pasojë e mbulimit të nevojave të familjes nga rrushi, do të ishte e papërfillshme. Ndërsa, pas vitit 1998, ndonëse subjekti ka pretenduar se ka mbjellë përpara shtëpisë së tij të banimit në \*\*\*, perime, për mbulimin e nevojave të familjes, fillimisht vlen të theksohet se toka me sip. 2000 m<sup>2</sup> në \*\*\* është në fakt truall dhe jo tokë bujqësore.
193. Megjithatë, edhe nëse do të pranohej pretendimi i subjektit, sipas INSTAT-it perimet zënë një pjesë prej përafërsisht 6.6% të shpenzimeve të jetesës, nga ku në rezultatin final do të kishim një ndryshim minimal të balancës negative, përkatësisht me 114.208 lekë, e cila nuk do të ndryshonte gjithsesi vlerësimin përfundimtar të Komisionit, lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit.

**10. Depozitë në “Societe General Albania”, në vlerën 300.023 lekë, në emër të vajzës së subjektit Ç. B.**

194. Në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e personit të lidhur, vajza e subjektit ka deklaruar një depozitë bankare në bankën “Societe Generale Albania” në vlerën 300.022 lekë, pa specifikuar burimin e krijimit të saj.
195. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se kjo depozitë është çelur fillimisht, me anë të depozitimeve *cash* si në vijim, si dhe është shtuar me të ardhurat nga interesat në masën 9.423 lekë: (a) 200.000 lekë në datën 21.2.2014; (b) 100.000 lekë në datën 22.4.2014; (c) 100.000 lekë në datën 15.5.2014; (ç) 200.000 lekë në datën 17.10.2014; (d) 100.000 lekë në datën 10.4.2015; (dh) 100.000 lekë në datën 16.6.2015.
196. Më pas, gjatë vitit 2016, vajza e subjektit ka tërhequr shumën prej 609.400 lekësh dhe gjendja e mbetur në këtë llogari depozite në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ka qenë në vlerën 200.023 lekë dhe jo 300.023 lekë.
197. Nga shqyrtimi i deklaratës periodike të viteve 2014 dhe 2015, vajza e subjektit – ndryshe nga kërkesat ligjore të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar – nuk ka plotësuar deklaratë të personit të lidhur dhe këto shtesa/depozitime nuk janë deklaruar.
198. Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bëjë me dije mbi burimin e ligjshëm të krijimit të depozitave në fjalë në vitet 2014 dhe 2015. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se vajza e tij, nga momenti i fillimit të detyrës dhe deri në momentin e shkëputjes nga trangu familjar, ka kursyer pjesën më të madhe të pagës së saj dhe në momentin e largimit ka pasur të kursyer rreth 1.000.000 lekë, vlerë që është përdorur për pagesat e kësteve të apartamentit të banimit dhe për këto depozitime.
199. Lidhur me sa më sipërpretenduar – duke u nisur nga fakti që referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, vajza e subjektit të rivlerësimit (e shkëputur nga trangu familjar apo jo) ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat, pasuritë dhe kursimet e saj – për sa kohë këto kursime nuk janë deklaruar në DIPP-të e viteve 2011 e në vijim, Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare si kursime të mbartura, për t’u përdorur më pas për depozitimet në fjalë.
200. Nisur nga analiza financiare e vitit 2014, trajtuar edhe në pikën 4 të këtij relacioni, duket se vajza e subjektit dhe bashkëjetuesi i saj nuk kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për të kryer investimet në depozitat me afat, për të gjithë shumën prej 600.000 lekësh.

Pas mbylljes së hetimit administrativ, lidhur me këtë depozitë, Komisioni i ka njoftuar subjektit këtë rezultat:

- *Duket se për krijimin e depozitës në fjalë në vitin 2014, vajza e subjektit të rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në shumën 600.000 lekë.*

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

201. Subjekti, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka shpjeguar se vajza e tij ka pasur kursime në shumën 1.000.000 lekë, të krijuar përpara momentit të largimit nga trangu familjar. Analiza financiare e vitit 2014 është një analizë e cunguar, e pastrukturuar dhe nuk pasqyron realitetin, pasi nuk është deklaruar që këto të ardhura i ka kursyer vetëm në vitin 2014, por në periudhën kohore 27.12.2010 – 25.4.2013.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

202. Trupi gjykues çmon se përderisa përgjatë periudhës kohore 27.12.2010 – 25.4.2013, vajza e subjektit ka qenë në përbërje familjare me subjektin dhe ka pasur detyrimin për të deklaruar të ardhurat, pasuritë dhe kursimet e saj, referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i cili në nenin 1 përcakton qëllimin e ligjit për përcaktimin e rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta. Për rrjedhojë, mosdeklarimi i krijimit të kursimeve dhe disponimit të tyre në gjendjen *cash*, jashtë sistemit bankar, nga personi i lidhur – duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën konstante të Kolegjit lidhur me këtë temë, të referuar edhe më sipër – nuk mundësohet përlllogaritja e tyre si shuma realisht të disponuara si gjendje *cash* në banesë, sikurse pretendohet nga subjekti, për sa kohë ato nuk janë deklaruar.
203. Megjithatë, vërehet se nga ndryshimet e kryera në analizën financiare, për vitin 2014, të vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit të saj, ky vit ka rezultuar me një balancë negative prej 577.346 lekësh<sup>76</sup>, për të kryer pagesën e këstit të apartamentit, për të përballuar shpenzimet e vitit, si dhe për të kryer investimet në depozitën në fjalë, të vajzës së subjektit.

### **REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE**

204. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksat më poshtë, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet, nga përlllogaritja krahasimore e të cilave mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të cilat i janë njoftuar subjektit si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ.
205. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të trajtuara në pikat e mësipërme të këtij vendimi, duket se për subjektin e rivlerësimit nuk ka ndryshime në rezultatin final të analizës financiare, duke mbetur në një balancë negative prej 2.190.725 lekësh. Ndërsa, për analizën financiare të vajzës së subjektit dhe bashkëjetuesit

---

<sup>76</sup>Kjo mungesë e burimeve të ligjshme është e përfshirë në balancën negative prej 1.853.111 lekësh të analizës totale të kryer për vajzën e subjektit dhe bashkëjetuesin e saj, të trajtuar në pasurinë nr. 4 të vendimit.

të saj, rezultati do të ishte negativ në masën 1.853.111 lekë. Edhe nëse pamjaftueshmëria financiare për pasurinë në bashkëpronësi midis vajzës së subjektit dhe z. A. H., do të kryhej në raport vetëm me investimet dhe burimet e saj, sërish ajo do të gjendej në një pamundësi financiare mbi një milion lekë, sikurse është specifikuar në paragrafin përkatës. Kësisoj, edhe sipas variantit të pretenduar nga subjekti, nuk do të përmysej bilanci negativ për këtë pasuri dhe, rrjedhimisht, as konkluzioni i përgjithshëm mbi analizën financiare sikurse mbi vendimmarrjen finale në kuadër të këtij procesi rivlerësimi.

206. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson të theksojë se në këtë analizë financiare nuk është përfshirë pamjaftueshmëria e burimeve të ligjshme financiare për apartamentin e ndodhur në Tiranë, në emër të bashkëshortes së subjektit, i blerë në vlerën 9.585.000 lekë, për sa kohë kjo pasuri është konsideruar si e fshehur nga subjekti dhe, kësisoj, ky kualifikim i prodhon efektet dhe pasojat e veta në mënyrë të drejtpërdrejtë, në zbatim të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës – sikurse është arsyetuar në analizë të pasurisë në fjalë – pa qenë nevoja për të rikonsideruar këtë pasuri edhe në këndvështrimin e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare nga familja e subjektit.

207. Në vijim paraqiten tabelat financiare të përgjithshme për familjen e subjektit të rivlerësimit, si dhe të vajzës së tij, lidhur me periudhën pasi kjo e fundit është shkëputur nga trungu familjar.

### Analiza e familjes së subjektit

| Viti  | Deri 1998  | 1999    | 2000     | 2001    | 2002    | 2003    | 2004      | 2005    | 2006       | 2007    | 2008    | 2009      | 2010      | 2011      | 2012      | 2013      | 2014      | 2015      | 2016      |   |
|---|------------|---------|----------|---------|---------|---------|-----------|---------|------------|---------|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|---|
| <b>PASURI</b>   | 2,669,149  | 500,000 | 0        | 100,000 | 0       | 0       | 18,752    | 246,991 | 104,340    | -74,931 | 40,160  | 39,131    | 570,851   | 1,276,347 | 671,694   | 1,188,551 | 361,600   | 341,099   | -573      |   |
| Shtëpi/bazim i në V***, Gjrokastrë 121 m <sup>2</sup> | 2,525,149  |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |
| Tokë bujqësore 3,200 m <sup>2</sup>                   |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |
| Automjet Mercedes Benz *** (***)                      |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           | 600,000   |           |           |           |           |           |           |   |
| Apartament në Gjrokastrë (vaja)                       |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           | 400,000   | 400,000   |           |           |           |           |   |
| Apartament në Tiranë bish (trashëgim)                 |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |
| Tiranë I në ***; Gjrokastrë                           | 144,000    |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |
| Automjet blerë në 1999/ shitur në 2004                |            | 500,000 |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |
| Ndryshim likuiditeti                                  | 0          | 0       | 0        | 100,000 | 0       | 0       | 18,752    | 246,991 | 104,340    | -74,931 | 40,160  | 39,131    | -28,149   | 876,347   | 271,694   | 1,188,551 | 361,600   | 341,099   | -573      |   |
| <b>TOTAL LIKUIDITET E DEKLARUAR</b>                   | 0          | 0       | 0        | 100,000 | 100,000 | 100,000 | 118,752   | 365,743 | 470,083    | 395,152 | 435,312 | 474,443   | 445,294   | 1,321,642 | 1,593,336 | 2,781,886 | 3,143,486 | 3,484,584 | 3,484,012 |   |
| <b>DETYRIME</b>                                       | 0          | 0       | 0        | 0       | 0       | 0       | 0         | 0       | 0          | 0       | 0       | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0         | 0 |
| <b>PASURI NETO</b>                                    | 2,669,149  | 500,000 | 0        | 100,000 | 0       | 0       | 18,752    | 246,991 | 104,340    | -74,931 | 40,160  | 39,131    | 570,851   | 1,276,347 | 671,694   | 1,188,551 | 361,600   | 341,099   | -573      |   |
| <b>Të ARDHURA dokumentuar</b>                         | 1,955,707  | 376,482 | 414,377  | 443,892 | 529,524 | 582,843 | 1,139,922 | 906,635 | 843,204    | 887,418 | 883,937 | 1,025,178 | 1,059,770 | 2,292,997 | 1,553,712 | 2,313,014 | 1,600,743 | 1,499,989 | 1,103,492 |   |
| Të ardhura SR vertetur                                | 1,955,707  | 376,482 | 414,377  | 443,892 | 529,524 | 582,843 | 1,139,922 | 906,635 | 843,204    | 887,418 | 883,937 | 1,025,178 | 1,050,619 | 1,860,848 | 1,103,898 | 1,999,134 | 1,336,743 | 1,499,989 | 1,103,492 |   |
| Të ardhura BSH vertetur                               | -          | -       | -        | -       | -       | -       | -         | -       | -          | -       | -       | -         | -         | -         | -         | 148,000   | 264,000   | -         | -         |   |
| Të ardhura vaja vertetur                              | -          | -       | -        | -       | -       | -       | -         | -       | -          | -       | -       | -         | 9,151     | 432,149   | 449,814   | 165,880   |           |           |           |   |
| <b>SHPENZIME</b>                                      | 620,080    | 408,478 | 532,000  | 425,456 | 425,456 | 425,456 | 454,885   | 488,228 | 517,903    | 546,586 | 619,414 | 608,480   | 614,938   | 642,882   | 648,136   | 661,150   | 916,545   | 1,111,949 | 1,101,541 |   |
| Shpenzime jetese                                      | 620,080    | 248,478 | 432,000  | 375,456 | 375,456 | 375,456 | 375,456   | 438,228 | 438,228    | 492,354 | 546,480 | 546,480   | 546,480   | 546,480   | 564,096   | 458,328   | 659,994   | 672,828   | 705,276   |   |
| Shpenzime për sigurimin e jetës                       |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           |           |           | 72,909    | 72,857    | 71,578    | 70,340    |   |
| Shpenzime për sigurimin e automjetit                  |            |         |          |         |         |         |           |         |            |         |         |           |           | 11,200    | 14,600    | 14,600    | 16,460    | 16,460    | 16,440    |   |
| Shpenzime udhëtimi                                    |            |         |          |         |         |         |           |         | 12,370     | 42,32   | 12,934  | 0         | 4,858     | 19,362    | 0         | 42,063    | 119,094   | 301,083   | 259,485   |   |
| Shpenzime mobilimi                                    |            | 160,000 | 100,000  | 50,000  | 50,000  | 50,000  | 50,000    | 50,000  | 50,000     | 50,000  | 50,000  | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 50,000    |   |
| Shpenzime për sigurim në bujqësi bish                 |            |         |          |         |         |         | 29,429    | 0       | 17,305     | 0       | 10,000  | 12,000    | 13,600    | 15,840    | 19,440    | 23,250    |           |           |           |   |
| <b>Analiza dokumentuar</b>                            | -1,333,522 | -31,996 | -117,623 | -81,564 | 104,068 | 157,387 | 666,285   | 171,416 | 220,961    | 415,763 | 224,363 | 377,567   | -126,020  | 373,768   | 233,882   | 463,313   | 322,599   | 46,942    | 2,523     |   |
| <b>CASH në lehtë</b>                                  |            |         |          |         |         |         |           |         | 50,000     | 50,000  | 50,000  | 50,000    | 50,000    | 50,000    | 250,000   | 450,000   | 750,000   | 750,000   | 750,000   |   |
| <b>DIFERENCA E PAMBULUAR</b>                          |            |         |          |         |         |         |           |         | -2,190,725 |         |         |           |           |           |           |           |           |           |           |   |

### Analiza e vajzës së subjektit

| Viti                               | 2013              | 2014              | 2015             | 2016              |
|------------------------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|
| <b>PASURI</b>                      | <b>1,673,761</b>  | <b>1,164,559</b>  | <b>762,087</b>   | <b>-609,711</b>   |
| Apartament në Gjirokastër          | 400,000           | 400,000           | 400,000          |                   |
| Ndryshim likuiditeti               | 1,273,761         | 764,559           | 362,087          | -609,711          |
| <b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b> | <b>1,273,761</b>  | <b>2,038,320</b>  | <b>2,400,407</b> | <b>1,790,696</b>  |
| <b>DETYRIME</b>                    | <b>0</b>          | <b>0</b>          | <b>0</b>         | <b>510,000</b>    |
| Kredi bankare RZB                  |                   |                   |                  | 510,000           |
| <b>PASURI NETO</b>                 | <b>1,673,761</b>  | <b>1,164,559</b>  | <b>762,087</b>   | <b>-1,119,711</b> |
| <b>Të ARDHURA</b>                  | <b>649,347</b>    | <b>1,049,627</b>  | <b>1,218,486</b> | <b>1,175,395</b>  |
| Të ardhura Ç. B. vertetuar         | 497,639           | 699,840           | 702,804          | 587,790           |
| Të ardhura A. H. vertetuar         | 151,708           | 349,787           | 515,682          | 587,605           |
| <b>SHPENZIME</b>                   | <b>251,351</b>    | <b>462,414</b>    | <b>448,552</b>   | <b>1,153,985</b>  |
| Shpenzime jetese                   | 211,536           | 439,996           | 448,552          | 470,184           |
| Shpenzime kredie RZB               |                   |                   |                  | 260,920           |
| Shpenzime mobilimi                 |                   |                   |                  | 351,864           |
| Shpenzime udhëtimi                 | 9,815             | 22,418            | 0                | 71,017            |
| Shpenzime qiraje                   | 30,000            |                   |                  |                   |
| <b>Analiza dokumentuar</b>         | <b>-1,275,765</b> | <b>-577,346</b>   | <b>7,847</b>     | <b>1,141,122</b>  |
| <b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>      |                   | <b>-1,853,111</b> |                  |                   |

208. Në vijim të analizës financiare të kryer të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, mbi deklarimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar, lidhur me të gjitha të dhënat mbi të ardhurat – në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës – shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja e tyre, familja e subjektit ka rezultuar me një balancë negative prej 2.190.725 lekësh, ndërsa vajza e tij me një pamjaftueshmëri financiare në masën 1.853.111 lekë. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se në këtë rast gjendemi përballë deklarimeve dhe burimeve të pamjaftueshme, të kualifikueshme në germet “b” dhe “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, duhet të aplikohet pika 3, e nenit 61, të po këtij ligji.

### B. KONTROLLI I FIGURËS

209. Nga DSIK-ja është kryer kontrolli i figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 është përcjellë në Komision një raport me nr.\*\*\* prot., datë 2.11.2017, me të cilin ishte konstatuar papërshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi. Në vijim, më 17.1.2018, është përcjellë informacioni shtesë i klasifikuar. Ky raport është deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.3.2021, të KDZH-së dhe është përcjellë në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.3.2021.
210. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për një përditësim, nga DSIK-ja është përcjellë informacion shtesë i klasifikuar, më 2 dhe 21 qershor 2021, i cili ka rikonfirmuar papërshtatshmërinë e subjektit. Nga komunikimet e mëtejshme me organet ligjzbatuese përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit.
211. Përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, transferuar më pas në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier. Në përfundim, procedimi penal

është pushuar me vendimin e datës 25.5.2017, pasi fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

212. Gjithashtu, ka rezultuar se veprimtaria e subjektit të rivlerësimit ka qenë objekt i një hetimi nga ILD-ja, si organi përgjegjës për hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj gjyqtarit dhe veprimtarisë së ushtruar prej tij. Në përfundim të këtij hetimi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2021, ILD-ja, bazuar në nenin 117 dhe në pikën 4, të nenit 124, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka konkluduar se nuk janë konstatuar veprime të subjektit në papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit. Gjithashtu, është vendosur arkivimi i ankesës së shtetases R. I., së bashku me praktikën e përcjellë nga KLD-ja (për fillimin e hetimit disiplinor) lidhur me këtë çështje.
213. Sipas raportit të DSIK-së, është konkluduar se disponoheshin të dhëna nga ku janë ngritur dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.
214. Komisioni, pasi ka hetuar në lidhje me të dhënat e paraqitura në raportin e DSIK-së dhe nga burime alternative, konstatimet e veta i ka paraqitur në rezultatet e hetimit administrativ, të cilat i janë bërë të njohura subjektit, bazuar në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
215. Për sa më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime bindëse lidhur me sa është konstatuar e konkluduar mbi këtë kriter.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

216. Subjekti ka pretenduar se kontrolli i figurës nga DSIK-ja është bërë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 38 të ligjit nr. 84/2014 dhe është i pabazuar në prova, por është bazuar në ankimin e bërë publik në media nga shtetasja R. I. Subjekti ka sqaruar se në lidhje me çështjen e bërë publike nga kjo shtetase, ai është shpallur i pafajshëm nga organet gjyqësore. Gjithashtu, ka deklaruar se edhe hetimi administrativ i iniciuar për shkak të çështjes në fjalë, është mbyllur me vendim të ILD-së, duke mos u konstatuar shkelje nga subjekti.
217. Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se Komisioni duhet të thellojë hetimin administrativ në lidhje me çështjen e sipërpërmendur, duke i kërkuar DSIK-së të hartojë një raport lidhur me personalitetin e shtetases R. I.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

218. Në lidhje me pretendimin e subjektit se Komisioni, sipas tij, duhet të hartojë një raport të vetin për këtë kriter, trupi gjykues vlerëson se ligji nr. 84/2016 në kreun V, “Kontrolli i figurës”, nuk parashikon detyrim për Komisionin për të hartuar një raport të posaçëm në lidhje me këtë kriter. Kjo kompetencë, referuar pikës 2, të nenit 39, të po këtij ligji, i është dhënë Grupit të Punës të DSIK-së, si organ ndihmës në procesin e rivlerësimit – ndonëse



Komisioni kryen një vlerësimi objektiv dhe tërësor, pasi shqyrton edhe të dhënat e klasifikuara, kur është rasti.

219. Komisioni, pasi analizoi dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit, kushtet dhe rrethanat e evidentuara përgjatë procesit të rivlerësimit, konstatoi se: (i) formulari i deklarimit për figurën ka qenë i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në “Deklaratën për kontrollin e figurës”; (iii) nga provat e administruara nga Komisioni dhe praktikantët e administruara nga organet e tjera ndihmëse në kuadrin e vlerësimit të figurës, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur ndonjëherë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikave 6 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar.
220. Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se nuk ka rezultuar i provuar ndonjë kontakt i papërshtatshëm apo tjetër shkelje që mund të kualifikohet sipas parashikimeve të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës ose nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të të cilëve subjekti mund të konsiderohej i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij si magjistrat dhe, për rrjedhojë, të mund të aplikohet dispozita e parashikuar në pikën 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
221. Megjithatë, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht se nuk jemi në kushtet e ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, apo deklarimit të pasaktë, konstatimet e DSIK-së, nga ku ngrihen dyshime për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike – ndonëse në vetvete nuk mund të përbëjnë shkak të mjaftueshëm për marrjen e një mase disiplinore, ato mund të mbahen në konsideratë për t’u vlerësuar në tërësi, për një vendimmarrje sa më objektive dhe gjithëpërfshirëse, nëpërmjet një ndërthurjeje të të gjitha elementeve të konstatuara që lidhen me etikën e subjektit, përfshirë këtu edhe informacionet e klasifikuara.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja**

222. KLGJ-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi.
223. Në raportin e KLGJ-së janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; si dhe (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Raporti në fjalë është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit; (ii) të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit;

- (iii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe  
(iv) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.
224. Sipas këtij raporti ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë eficient dhe efektiv në çështjet që ka shqyrtuar dhe ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara, ku rezultoi se gjykimet kanë përfunduar brenda afatit ligjor apo në respektim të afatit standard.
225. Subjekti ka shfaqur të njëjtat aftësi për të kryer si duhet procedurat gjyqësore edhe në tri dokumentet ligjore të prezantuara prej tij, ku gjykimet kanë përfunduar në respektim të afatit standard. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.
226. Gjithashtu, nga raporti është evidentuar se subjekti ka filluar detyrën si gjyqtar me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.2.1996, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në vijim, z. Guximtar Boçi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2013, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
227. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Guximtar Boçi është shkarkuar nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, është pezulluar nga detyra e gjyqtarit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për çështjen penale në ngarkim të tij.
228. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave ka rezultuar se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Guximtar Boçi janë paraqitur gjithsej 8 ankesa pranë ish-KLD-së. Nga këto ankesa:
- a) 3 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se për 2 prej tyre pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 1 prej tyre me arsyetimin se është ankesë e përsëritur;
  - b) 1 ankesë e vitit 2015, me pretendime për fillim të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit Guximtar Boçi është nxjerrë jashtë kompetencave të Inspektoratit të ish-KLD-së dhe është përcjellë për kompetencë pranë Ministrisë së Drejtësisë;
  - c) 3 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë, si vijon:
    - 1 ankesë e vitit 2013, verifikuar për shkelje etike, ka rezultuar pa shkelje nga ana e gjyqtarit dhe, si e tillë, është arkivuar;
    - 1 ankesë e vitit 2016 publike, mediatike, verifikuar për shkelje etike ndaj gjyqtarit Guximtar Boçi, në cilësinë e kryetarit të gjykatës. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, ka vendosur shkarkimin e z. Guximtar Boçi nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Ndërkohë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, është pezulluar nga detyra e gjyqtarit deri në marrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë për çështjen penale në ngarkim të tij. Në përfundim, nuk kanë rezultuar shkelje nga ana e gjyqtarit dhe ankesa është arkivuar;

- 1 ankesë e vitit 2015, me pretendime për mosrespektim formal ligji, për të cilën nuk ka të dhëna në regjistrin e protokollit për ecurinë e saj dhe nuk gjendet fizikisht në arkivin e KLGJ-së.

229. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Guximtar Boçi përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
230. KLGJ-ja ka konstatuar se në një rast, ku zgjidhja në themel e çështjes nga gjyqtari Guximtar Boçi, është vlerësuar e gabuar nga gjykata e apelit, e cila e ka cenuar (ndryshuar) vendimin e tij, duke i dhënë çështjes një zgjidhje të kundërt me atë të gjyqtarit Boçi<sup>77</sup>. Vendimi i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë në këtë rast është kundërshtuar me rekurs nga palët në Gjykatën e Lartë, e cila ende nuk ka disponuar mbi çështjen. Ndërsa në një rast tjetër vendimi i dhënë nga subjekti i rivlerësimit është ndryshuar pjesërisht. Dy vendime kanë marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

## **C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

231. Komisioni, në bazë të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e përcjellë nga ky institucion, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
232. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KGJ-ja, mbi të cilin ishte hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, përgjithësisht sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, por edhe atyre të administruara mbi bazë shorti, nuk vërejti problematika të natyrës procedurale veç tejkalimit të afatit procedural të kohëzgjatjes së gjykimit në një rast<sup>78</sup>.
233. Gjithashtu, KLGJ-ja ka konstatuar se zgjidhja e dhënë nga gjyqtari Guximtar Boçi është cilësuar e gabuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë<sup>79</sup>. Kjo gjykatë ka ndryshuar plotësisht vendimin e dhënë nga subjekti me nr. \*\*\*, datë 14.7.2016, dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2016, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, ka vendosur *pranimin e padisë së palës paditëse*. Ndaj këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila nuk është shprehur ende me një vendim.
234. Lidhur me sa është konstatuar më sipër, Komisioni e ka ftuar subjektin të paraqesë shpjegime bindëse, si dhe dokumentacionin provues në mbështetje të argumenteve të tij.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

235. Subjekti ka shpjeguar se në marrjen e vendimit nga ana e tij për këtë çështje ka analizuar dhe vlerësuar në tërësi provat në lidhje me çështjen. Në përfundim, ai ka çmuar se pretendimet e palës paditëse rezultuan të pabazuara në prova dhe, për rrjedhojë, është rrëzuar kërkesëpadia.

---

<sup>77</sup>Në dosjen nr.2.

<sup>78</sup>Në çështjen që i përket në dosjes nr. 1, të shqyrtuar nga KLGJ-ja.

<sup>79</sup>Çështjen që i përket dosjes nr. 2.

236. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se në vijim gjykata e apelit e ka ndryshuar vendimin e dhënë prej tij dhe ka pranuar kërkesëpadinë, duke bërë një vlerësim tjetër të provave, të ndryshëm nga vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë. Sipas subjektit, gjykata e apelit nuk ka administruar ndonjë provë të re në këtë proces për të përmbysur si vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

237. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pas analizës së dokumentacionit të administruar përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se gjykimi apo vlerësimi mbi zgjidhjen e një çështjeje gjyqësore në themel, dhe specifikisht mbi çmimin e provave, nuk është objekt vlerësimi në funksion të procesit të rivlerësimit, për sa kohë që çmimi i tyre mbështetet mbi bindjen e brendshme të subjektit të rivlerësimit.

238. Në rastin konkret, pikërisht vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit, duke gjykuar dhe vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar dhe të shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjykuese përkatëse, duke arsyetuar mbi provat e të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë tagrave të Komisionit. Për rrjedhojë, konkluzioni i arritur nga KLGJ-ja, se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, nuk është objekt i vlerësimit të Komisionit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret si një element për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

#### **Në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit, pranë ish-KLD-së**

239. KLGJ-ja, në raportin e dërguar pranë Komisionit, ka konstatuar se sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin Guximtar Boçi janë paraqitur 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 7 prej tyre janë verifikuar dhe më pas arkivuar, pasi nuk janë konstatuar shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit. Ndërsa në lidhje me ankesën e vitit 2016 nga shtetasja R. I., ndaj subjektit është marrë vendimi për pezullimin e tij nga ushtrimi i detyrës.

240. Në përgjigje të kërkesës<sup>80</sup> së Komisionit, KLGJ-ja ka përcjellë dokumentacionin<sup>81</sup> lidhur me çështjen në fjalë. Nga shqyrtimi i tij është konstatuar se shtetasja R. I. në vitin 2016 kishte bërë një denoncim në një emision investigativ ndaj kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shtetasit Guximtar Boçi. Ajo ka pretenduar se ishte shantazhuar, duke iu kërkuar favore seksuale në këmbim të mbështetjes për të fituar çështjen gjyqësore ku denoncuesja ishte palë.

241. Nisur nga sa më sipër, Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, bazuar në faktet e bëra publike nga media, i është drejtuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë (sipas ligjit të kohës), duke i kërkuar shkarkimin nga pozicioni drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z. Guximtar Boçi.

242. Në vijim, KLGJ-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, ka vendosur *shkarkimin nga funksioni drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë*, ndërsa me

<sup>80</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2021.

<sup>81</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021.

vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, ka vendosur *pezullimin nga ushtrimi i detyrës të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z. Guximtar Boçi, deri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë për çështjen penale të regjistruar në ngarkim të tij.*

243. Gjithashtu, mbi bazën e të dhënave të siguruara nga emisioni investigativ “\*\*\*\*”, ku rasti është prezantuar si korrupsion i shfaqur në formën e një regjistrimi audio, ku përfshihet shtetasja e identifikuar si R. I. dhe një person i dyshuar si kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, z. Guximtar Boçi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda në datën 27.10.2016 ka regjistruar kryesisht procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “korrupsion pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Në datën 18.1.2017 kjo prokurori ka vendosur të deklarojë moskompetencën lëndore dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
244. Në vijim, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, mbi bazën e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2016, të dërguar për kompetencë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, me kallëzuese shtetasen R. I., ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, datë 27.1.2017, për veprën penale “ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 25.5.2017.
245. Vendimi i sipërcituar është ankimuar nga shtetasja R. I., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, ka vendosur *pranimin e kërkesës*, prishjen e vendimit datë 25.5.2017 për “Pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*\*”, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve të mëtejshme në lidhje me detyrat e caktuara nga gjykata.
246. Më pas, vendimi i sipërcituar i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin penal nr. \*\*\*, datë 27.9.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.7.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si vijon: “*Rrëzimin e ankimit të ankueses R. I...*”. Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe çështja vijon të jetë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë.
247. Nga aktet e përcjella nga KLGJ-ja ka rezultuar se me krijimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kjo praktikë i është dërguar për kompetencë këtij institucioni, me shkresën përcjellëse nr. \*\*\* prot., datë 6.7.2020, shoqëruar me procesverbalin nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020.
248. Subjekti, nëpërmjet kërkesës së ripërsëritur nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2018, i është drejtuar KLGJ-së, duke i kërkuar revokimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, “Për pezullimin nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”, revokimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, “Për shkarkimin nga funksioni drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”, si dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës.
249. Subjekti i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. \*\*\* datë 28.10.2016, “Për shkarkimin nga funksioni

drejtues i kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë”.

250. Në datën 12.11.2019 është mbledhur KLGJ-ja me qëllim shqyrtimin e kërkesës së subjektit dhe në përfundim ka vendosur, duke e bërë me dije edhe subjektin, se do të vijojë të jetë i pezulluar deri në përfundim të procesit në gjykatën administrative.
251. ILD-ja ka bërë me dije se pas kryerjes së procedurave të verifikimit ka miratuar vendimin nr. \*\*\* prot., datë 29.10.2021, “Për arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara ndaj magjistratit Guximtar Boçi dhe magjistrates B. Ç.”. Nga shqyrtimi i këtij vendimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankesë pranë ILD-së, e cila është regjistruar me nr. \*\*\*, datë 10.6.2021. Nëpërmjet kësaj ankese ai ka pretenduar mbylljen e hetimit disiplinor të filluar ndaj tij nga ish-Inspektorati i KLD-së.
252. Ndër të tjera në këtë vendim, ILD-ja ka arsyetuar se nga shqyrtimi në tërësi i akteve të administruara prej saj, bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 28.10.2016, të KLD-së, ku është vendosur inspektimi i veprimtarisë së gjyqtarit Guximtar Boçi – si dhe ankesës që ky i fundit i ka drejtuar ILD-së për përfundimin e hetimit disiplinor të nisur ndaj tij, që i referohen sjelljes dhe akteve procedurale të tij përgjatë vitit 2015 – nuk janë konstatuar veprime të subjektit në papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit. Për rrjedhojë, ILD-ja, bazuar në nenin 117 dhe pikën 4, të nenit 124, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës dhe praktikës së përcjellë nga KLD-ja.
253. Komisioni ka kryer gjithashtu hetime<sup>82</sup> edhe në lidhje me procedime penale të mundshme të mosfilluara, pushuara apo pezulluara ndaj subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi ka rezultuar se ndaj tij është depozituar një kallëzim penal<sup>83</sup>, i cili është trajtuar më sipër në mënyrë të detajuar, në shqyrtimin e dokumentacionit të administruar nga KLGJ-ja.
254. Nisur nga fakti se shtetasja që ka bërë kallëzim, gjithashtu ka depozituar edhe një denoncim pranë Komisionit, thajse me të njëjtin objekt ankimi, si dhe nisur nga fakti që kjo çështje është bërë publike në media, dhe më konkretisht në emisionin investigativ “\*\*\*\*” në TV K., Komisioni ka vlerësuar të trajtojë dhe të analizojë këtë fakt në raport me shpjegimet dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit ndaj pretendimeve të kësaj shtetaseje, duke i paraqitur në vijim, nën titullin “Fakte të bëra publike nga media”.

#### DENONCIME NGA PUBLIKU

255. Pranë Komisionit janë paraqitur nga publiku 4 denoncime. Të gjitha denoncimet janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Nga vijim, nga shqyrtimi i tyre bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar si më poshtë vijon:
- 1. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2018, të shtetasit E. K.**
256. Shtetasi E. K. ka denoncuar disa gjyqtarë për vendimmarrje të padrejtë ndaj vrasësit të vëllait të tij, duke ngritur pretendimin se dënimi për të ka qenë i ulët dhe trupa gjyqësore

<sup>82</sup>Kërkesës nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

<sup>83</sup>Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.2020, ka përcjellë informacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

ka qenë e korruptuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar, me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, ka vendosur *deklarimin fajtor të të pandehurit G. M. dhe të shtetasit G. S.*, vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë me nr.\*\*\*, datë 19.6.2015, e cila ka vendosur *lënien në fuqi të vendimit penal*.

257. Kundër vendimit penal nr. \*\*\*, datë 19.6.2015, kanë ushtruar të drejtën e rekursit palët dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2016, ka vendosur *mospranimin e rekursit të ushtruar nga i gjykuari G. M. dhe prokurori*.

258. Nga shqyrtimi i vendimeve të lartpërmendura nuk janë konstatuar shkelje procedurale ose/apo të drejtave të palëve, apo arsyetim të dobët dhe/ose të paplotë/munguar, që mund të ishin kryer nga trupi gjykues, ku ishte pjesë edhe subjekti i rivlerësimit. Lidhur me pretendimet e denoncuesit mbi aludime të një vendimi të padrejtë, Komisioni vlerëson se ato ngrihen mbi themelin e vendimit, rrethanë kjo që nuk është objekt shqyrtimi nga organet e rivlerësimit.

## **2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 12.12.2017, i shtetasit i Th. V.**

259. Denoncuesi ka akuzuar disa gjyqtarë, midis tyre edhe subjektin e rivlerësimit, me pretendimin për dhënie dënimi të ulët, pasi gjyqtarët janë të korruptuar. Denoncuesi ka pretenduar se nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 3.12.2015, trupi gjykues i përbërë nga P.V., Guximtar Boçi dhe M. I., në të cilin subjekti ka qenë në cilësinë e anëtarit, ka dënuar të pandehurin G. M., akuzuar për veprën penale “vjedhje me dhunë e kryer në bashkëpunim”, me 12 vjet burg.

260. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, së bashku me denoncimin ka rezultuar se ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, për sa i përket të pandehurit G. V. Në vijim çështja është rekursuar në Gjykatën e Lartë, ku është në proces studimi.

261. Në përfundim të shqyrtimit të denoncimit, si dhe të vendimeve të gjykatave përkatëse bashkëlidhur me të, ka rezultuar se denoncuesi ka ngritur pretendime mbi dënimin e padrejtë të djalit të tij. Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e denoncuesit kanë rezultuar deklarative, që i referohen themelit të çështjes dhe të pabazuara mbi rrethana specifike, duke mos referuar ndonjë shkelje konkrete procedurale apo arsyetimi të kryer nga subjekti i rivlerësimit.

## **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018, i shtetasit E. L.**

262. Denoncuesja ka akuzuar disa gjyqtarë dhe prokurorë për qëndrime të njëanshme në vendimin nr. \*\*\*, datë 12.5.2016, sipas së cilit ajo ka pretenduar se është dënuar padrejtësisht, pasi gjyqtarët dhe prokurori kanë mbajtur anën e kallëzuesit. Në gjykimin e kësaj çështjeje subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues. Nga denoncimi dhe dokumentacioni shoqëruesi tij ka rezultuar se vendimi i sipërcituar është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.7.2016, dhe aktualisht çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë, pasi denoncuesja ka paraqitur rekurs pranë kësaj gjykate.

263. Nga shqyrtimi i vendimit objekt denoncimi, duket se nuk janë evidentuar, pretenduar apo konstatuar shkelje procedurale të kryera nga subjekti apo arsyetim i dobët ose shkelje të të drejtave të palëve, të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të tij, për sa kohë pretendimet lidhen me themelin e vendimmarrjes, vlerësim ky që, sikurse është përmendur edhe më sipër, nuk hyn në tagrat e organeve të rivlerësimit.

#### **4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2018, i shtetas R. I.**

264. Denoncuesja ka depozituar denoncim për gjashtë prokurorë dhe gjyqtarë, ndërmjet tyre edhe për subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar gjykim jo të drejtë të çështjes, manipulim dhe tjetërsim të provave të çështjes penale. Nga shqyrtimi i denoncimit ka rezultuar se shtetasja R. I. ka qenë e përfshirë në një proces gjyqësor me ish-bashkëshortin e saj dhe familjen e tij, për ndarje pasurie. Gjykimi zhvillohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Denoncuesja i është drejtuar edhe emisionit investigativ “\*\*\*” në TV K., i cili transmetoi rastin ku dukej se ishte përfshirë edhe subjekti i rivlerësimit. Sipas denoncueses, subjekti kërkonte favore seksuale prej saj, për ta favorizuar në lidhje me çështjen gjyqësore që kishte në këtë gjykatë. Regjistrimi i transmetuar përmbante të dhëna të gjyqtarit në regjistrim audio.

265. Gjithashtu, shtetasja e sipërcituar, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2022, ka ridërguar denoncimin ndaj subjektit të rivlerësimit, në të cilin ka ripërsëritur të njëjtat pretendime si në denoncimin në fjalë.

266. Nga aktet e administruara përgjatë hetimit në lidhje me këtë çështje, ka rezultuar se të dy denoncimet janë të njëjtë me ankesën e paraqitur nga kjo shtetase pranë ILD-së dhe i referohen të njëjtave fakte – të cilat do të trajtohen në paragrafin e mëposhtëm, së bashku me shpjegimet përkatëse që ka paraqitur subjekti i rivlerësimit.

#### **LIDHUR ME DISA FAKTE PUBLIKE**

267. Sikurse është përshkruar më sipër, lidhur me denoncimet e paraqitura nga shtetasja R. I., në media është bërë publike një ankesë e kësaj shtetaseje ndaj gjyqtarit Guximtar Boçi, në cilësinë e kryetarit të gjykatës, me objekt “sjellje të tij në shkelje të etikës”.

268. Në këto kushte, Komisioni, përpos hetimit të kryer lidhur me këtë fakt, si më lart është përshkruar, ka ftuar subjektin që të shpjegojë bindshëm për sa është konstatuar, publikuar, pretenduar dhe përshkruar në denoncimet përkatëse, si dhe në ankesën e lartpërmendur.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

269. Subjekti ka parashtruar se çështja gjyqësore objekt denoncimi në emisionin investigativ “\*\*\*” të TV K. nuk është gjykuar prej tij, por nga një gjyqtare tjetër. Ai ka pretenduar se ngjarja është sajuar nëpërmjet një audio regjistrimi të përgatitur për një periudhë 6-mujore, me qëllim denigrimin e figurës së tij pa asnjë bazë. Ai ka sqaruar se mbi bazën e kësaj ngjarjeje janë marrë disa vendime ndaj subjektit, si: shkarkimi nga detyra si kryetar i gjykatës; pezullimi i ushtrimit të funksionit si gjyqtar; si dhe vendimi për ngritjen e grupit të kontrollit për veprimtarinë e tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Gjithashtu, ndaj tij është regjistruar procedimi penal në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për veprën penale “korrupsion pasiv”.



270. Në lidhje me këtë procedim, Prokuroria e Krimeve të Rënda, bazuar në një aktekspertim ka konstatuar se audio përgjimi ishte një sajesë e emisionit dhe denoncueses, pasi nuk disponohej mjete me të cilin ishte realizuar regjistrimi i pretenduar dhe konkludoi se nuk u provua ekzistenca e veprës penale për të cilën kjo prokurori ishte kompetente dhe e dërgoi çështjen për kompetencë pranë Prokurorisë së Rrethit Fier, me qëllim hetimin për ekzistencën e veprës penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”.
271. Në përfundim të hetimit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale “ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 245/1 i Kodit Penal. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim denoncuesja në Gjykatën e Apelit Vlorë. Kjo e fundit, në datën 29.9.2018 ka vendosur rrëzimin e kërkesës së saj. Më pas ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, ku çështja nr. \*\*\*, me objekt “ankim kundër vendimit datë 25.5.2017, ‘Për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier’”, vijon të jetë në proces shqyrtimi.
272. Subjekti ka pretenduar se sipas vendimit unifikues penal nr. 2/2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të drejtën për të ankimuar këtë vendim e ka personi nën hetim dhe prokurori, pasi personat e tjerë kanë pasur rolin procedural të deklaruesve në këtë proces. Nga ana tjetër, vendimi i pushimit të çështjes penale vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 462 të Kodit të Procedurës Penale, por si ish-KLD-ja edhe KLGJ-ja nuk e kanë marrë parasysh këtë përcaktim ligjor, duke bërë që subjekti të vijojë i pezulluar për disa vite.
273. Subjekti i është drejtuar me kërkesën e datës 9.6.2017 ish-KLD-së për rikthimin në detyrë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ai ka përsëritur kërkesën në datën 29.10.2019, në përgjigje të së cilës i është bërë me dije se me vendimin nr. \*\*\*, të Këshillit të Lartë Gjyqësor është vendosur pezullimi i shqyrtimit të kërkesës së tij, pasi të njëjtat kërkesa janë objekt shqyrtimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Ndërsa ILD-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.10.2021, ka vendosur mbylljen e hetimeve dhe arkivimin e ankesave të bëra ndaj z. Guximtar Boçi.
274. Subjekti ka deklaruar se ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për dy vendimet, atë të pezullimit dhe të shkarkimit të dhëna nga KLD-ja, me pretendimin se ato janë akte administrative absolutisht të pavlefshme, pasi janë marrë në kapërcim të kompetencave ligjore.
275. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.2018, Gjykata Administrative Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke pranuar vetëm kërkimin lidhur me pagimin e pagës gjatë kohës së pezullimit. Subjekti ka paraqitur ankim ndaj vendimit të mësipërm në Gjykatën Administrative të Apelit, me pretendimin se vendimi është marrë në tejkalim të kompetencës funksionale dhe lëndore të gjykatës administrative, në interpretim të gabuar të ligjit organik, në kundërshtim me parimet e një gjykimi të drejtë dhe të në kundërshtim me praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me pavlefshmërinë absolute, si dhe në kundërshtim me ligjin nr. 49/2012, nenet 7 dhe 17 të tij.

276. Subjekti ka ngritur padi edhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, duke pretenduar se i është ndërprerë paga padrejtësisht. Kjo gjykatë, me vendimin nr.\*\*\*, datë 28.5.2018, ndër të tjera, ka vlerësuar se KLD-ja, në bazë të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm, është organi punëdhënës i gjyqësorit dhe, për rrjedhojë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë nuk mund të jetë e paditur. Gjithashtu, gjykata ka arritur në konkluzionin se jemi para gjësë së gjykuar dhe ka vendosur: *“Pushimin e gjykimit të çështjes për sa i përket kërkimeve për kthimin e pagave të mbajtura padrejtësisht, pagimin e pagës për gjithë kohën e pezullimit dhe vënien në ekzekutim të përkohshëm të vendimit, pezullimin e gjykimit të çështjes për pagimin e dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar deri në përfundim të zgjidhjes së çështjes tjetër administrative”*.
277. Vendimi i mësipërm është ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit nga subjekti, me pretendimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë ka qenë i pabazuar në ligj dhe në prova, ku vijon të jetë në shqyrtim.
278. Subjekti ka pretenduar se Kushtetuta e Shqipërisë, në nenin 140, pika 3, parashikon se: *“Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal arrest në burg ose arrest në shtëpi për kryerjen e një veprë penale; ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; kur fillon procedimi disiplinor sipas ligjit”*. Në këtë këndvështrim, ai ka deklaruar se nuk gjendet në asnjë nga rrethanat që parashikon dispozita e sipërcituar. Në nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: *“Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen në të njëjtën kohë mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë”*.
279. Sipas vendimit të pushimit të çështjes penale, është pretenduar se shkelja ka ndodhur në shkurt të vitit 2014 dhe deri në shkurt të vitit 2019 është përmbushur afati i parashkrimit. Sipas tij, KLGj-ja ka marrë vendim për pezullim procedure në datën 29.10.2016, në kundërshtim me përcaktimin e mësipërm, pasi afati i parashkrimit fillon nga dita kur shkelja e pretenduar është kryer.
280. Subjekti ka deklaruar se ka ngritur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për shpërblim dëmi jopasuror nga shtetasja R. I. dhe TV K., por për rreth dy vite çështja vijon në proces shqyrtimi në gjykatën e shkallës së parë.
281. Në përfundim, subjekti ka pretenduar se shkak i pezullimit të tij nga detyra ka rënë, çështja penale është pushuar dhe ankime të ndaj këtij vendimi janë rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Afati maksimal kohor për marrjen e masës së pezullimit është ezauruar, ndërkohë që organi kompetent nuk ka caktuar afat kohor për masën. Sipas raportit të Inspektoratit të ish-KLD-së, nga hetimi disiplinor administrativ nuk ka rezultuar ndonjë shkelje që ka lidhje me detyrën e kryetarit të gjykatës.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

282. Nga shqyrtimi i shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në përfundim të analizës së dokumentacionit provues të administruar përgjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se procedimi administrativ dhe ai penal të iniciuar ndaj subjektit

të rivlerësimit kanë përfunduar, duke mos konstatuar përgjegjësi të subjektit. Konkretisht, në lidhje me procedimin/hetimin administrativ është vendosur arkivimi i ankesave të paraqitura ndaj tij, për shkak se nuk janë evidentuar shkelje të kryera nga subjekti. Ndërsa, në lidhje me procedimin penal të filluar ndaj tij ka rezultuar se nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë është vendosur pushimi i çështjes për shkak se nuk janë evidentuar elementë të veprës penale – ndonëse kjo çështje është në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

283. Ndërkohë që vijon të jetë duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit masa e pezullimit që është dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit. Komisioni vlerëson se rrethanat faktike të parashtruara nga subjekti dhe pasojat e ardhura prej tyre, siç është parashtruar më sipër, janë objekt shqyrtimi i organeve kompetente përkatëse.
284. Megjithatë, pas analizimit të dokumentacionit të administruar përgjatë hetimit, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se, në këtë moment, çështja e sipërcituar nuk mund të përbëjë në vetvete një rrethanë penalizuese, për sa kohë ajo është ende në shqyrtim, *sub judice*.
285. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se në këtë stad, për sa kohë vendimet e lart përmendura, të dhëna nga organet kompetente, e kanë përjashtuar përgjegjësinë penale dhe/ose etiko-disipliniore të subjektit lidhur me këtë fakt, në këto kushte Komisioni, përpos ekzistencës së dyshimeve të mundshme, Komisioni është në pamundësi për të pohuar të kundërtën.
286. Gjithsesi, Komisioni vlerëson të theksojë se, ndonëse faktet e lartpërmendura mbartin një peshë specifike të lartë, nëse do të provoheshin, si dhe një ndjeshmëri të veçantë në perceptimin e publikut në raport me vendimmarrjen përfundimtare të procesit të rivlerësimit që është kryer nga Komisioni ndaj subjektit, kjo rrethanë nuk do të ishte vendimtare – edhe pse do të mund të shtonte elementet e cenimit të besimit të publikut – për sa kohë në një vlerësim të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara në të tria kriteret rivlerësimit janë konstatuar mjaftueshëm shkaqe të tjera që, në vlerësim të trupit gjykues, kanë çuar në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, sikurse do të specifikohen në vijim.

### **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Guximtar Boçi:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë: (i) ka pasur mungesë të theksuar të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara; (ii) ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe ka fshehur pasurinë apartament banimi të ndodhur në Tiranë, të regjistruar totalisht në emër të bashkëshortes së tij. Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues, bazuar në përfundimet e arritura, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me

të, në kuptim të pikave 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germave “b” dhe “c”, pika 5, e nenit 33, të ligjit nr.84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

- b. Në lidhje me kontrollin e figurës nuk janë provuar faktet që mund të çonin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme dhe as problematika lidhur me deklarimin e kryer për këtë kriter. Kësisoj, Komisioni – përpos dyshimeve të ngritura dhe të mundshme – nuk mund të shprehet për një papërshtatshmëri të subjektit lidhur me këtë kriter rivlerësimi, për sa kohë nuk provohen elementet specifike të kërkuar për një konkludim të tillë.
- c. Në lidhje me aftësitë profesionale nuk kanë rezultuar problematika të mjaftueshme që mund të çonin në vlerësimin e tij si të papërshtatshëm lidhur me këtë kriter, për sa kohë vlerësohet se arrin së paku në pragun minimal të kërkuar nga dispozita përkatëse.
- d. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara përgjatë arsyetimit të këtij vendimi dhe, konkretisht: (i) përfitimi i truallit dhe tokës me “okupim”; (ii) përfitimi i truallit me sip. 400 m<sup>2</sup>, jo në përputhje me kriteret ligjore, me qëllimin “për strehim” dhe, më pas, mospërdorimi nga subjekti për qëllimin e përfituar, por shitja e tij vetëm një ditë pas blerjes, në vlerën rreth 5-fish të çmimit të blerjes; (iii) qasja pasive dhe indiferente ndaj parregullsive në regjistrimin e një pasurie apartament 100% në emër të bashkëshortes së tij, ndërkohë që (edhe nëse mënyra e përfitimit do të kishte qenë e pavesuar nga fshehja e pasurisë) asaj do t’i përkisnin vetëm 50% e të drejtave reale, të cilat përbëjnë elemente faktiko-ligjore, që bien ndesh me etikën e figurës së magjistratit, konkurrojnë së bashku dhe në gërshetim midis tyre krijojnë bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë dhe, rrjedhimisht, çojnë edhe në aplikimin e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, duhet t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Guximtar Boçi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, aktualisht i pezulluar.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 10.5.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**

**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**

**Relator**

**Suela ZHEGU**

**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*

*Ertugena Sokoli*